

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7700 E hënë 5 Nëntor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Ngjarja e Bulararit, ku një i vetëquajtur "ushtar i Vorio Epirit" u ekzekutua ndërsa sulmoi pa asnjë shkak Policinë e Shtetit shqiptar ...

Vijon në faqen 20

Nga MUJË BUÇPAPAJ

Pas Bulararit, ushtarët grekë duhet të përcillen në atdhe



Dje

në "Deutsche Welle"

Më 5 nëntor, sanksionet amerikane synojnë të godasin zemrën ekonomike të Republikës Islamike, eksportin e energjisë. Nga kjo ditë ndalen ...

Vijon në faqen 21

Nga MATTHIAS HEIN

SHBA, sanksionet më të ashpra ndonjëherë kundër Iranit



Bie prova e komunikimeve telefonike

Gjykata "rrëzon" prokurorinë: 30 ditë burg për Ervis Martinajn

Organi hetimor kërkoi burg pa afat. Dy dëshmitë e plota të Redi Popeskut: Si ndodhi krimi në Bllok

Pas kërkesës së prokurorisë, gjykata ka vendosur 30 ditë burg të tjera për Ervis Martinajn, një nga protagonistët e përfshirë në masakrën e 4 tetorit në ish-Bllok. Gjykatësi Artan Gjermeni "rrëzoi" dy nga provat e prokurorisë, ato për komunikimet telefonike dhe ekspertimin kimik, duke e nxitur organin hetimor të kërkojë prova të tjera ...

Në faqet 6-7

TAKIMI/ KRYEMINISTRI SHKON NE PRESIDENCE: BASHKEBISEDIM KONSTRUKTIV

LETRA PER SANDER LLESHIN, META-RAMA, KOKE ME KOKE

Kreu i shtetit i shkruajti kreut të qeverisë arsyet e mosdekretimit të ministrit të Brendshëm. Basha: Largimi i Ramës, lëvizje e ashpër, jo lojë shahu



(Në foto) Kryeministri Edi Rama dhe Presidenti Ilir Meta

Në faqet 2-3

PERPLASJA ME ARME

Ceremoni në Bularat, nëna e Kaçifës: Ishte hero i Vorio-Epirit

Në faqen 9

INTERVISTA

Mimoza Hafizi: Për jetën përtej tokës, në një roman me shkencë e rrëfim

Në faqen 11

DIPLOMACI

MPJ: Ka agresion ndaj Kosovës, BE të reagojnë kundër Beogradit zyrtar

Në faqen 18

TIRANE

Banorët, në protestë për Unazën e Madhe: Dëshpërlim real

Në faqen 8

"LIFE PAGES"



Suplementi i shëndetit, mjekja: Si të parandalojmë problemet e zemrës

Suplement

INTERVISTA/ Ish-ambasadori ynë në Greqi: Çamët të lejohen të kërkojnë pronat

"Asnjë pakt me Greqinë, pa hequr ligjin e luftës"

Vili Minarolli: Negociatat u shtynë, bisedimet me Athinën tani pa interes

NGA VALENTINA MADANI

Vili Minarolli, tashmë i shkëputur nga jeta politike dhe ajo diplomatike, ndërkohë që vitet e fundit i është përkushtuar publicistikës përmes romanit "Trafikantët", paralajmëroi dy vite më parë "Kërcënimet dhe



vrasje, hakmarrje dhe pushtet, tradhti dhe para". Z.Minarolli përmes "Gazeta Shqiptare" shprehet kritik për situatën në vend, teksa thotë se i ka njohur ata që erdhën në pushtet përmes vjedhjes së votës me paratë e krimit. Ish-drejtuessi i lartë i PD-së vlerëson ...

Në faqet 4-5

DEKRETIMI REAGIMET

"Rrëzimi" i Lleshit, kreu i PD: Dëshmi e krizës së thellë politike dhe morale

Basha: Largimi i Ramës, lëvizja e ashpër dhe jo lojë shahu

"Presidenti ka ushtruar kompetencat e tij"

Valentina Madani

Rënia e ministrit të tretë të Brendshëm, sipas kreut të opozitës, Lulzim Basha është dëshmi e krizës së thellë politike dhe morale të mazhorancës. Nga Korça, Basha deklaroi se lëvizja më e ashpër në atë që nuk do të jetë lojë shahu, është largimi i Edi Ramës. Lulzim Basha shprehet se është kompetencë dhe detyrë e kreut të shtetit të argumentojë vendimin e tij për mosdekretimin e ministrit të Brendshëm. Gjithsesi, mosdekretimin e Sandër Lleshit e sheh si dëshmi të krizës së qeverisjes "Rama". "Presidenti ka kompetencat e tij kushtetuese dhe jam i sigurt që ai do të japë të gjithë aspektin kushtetues për dekretimin apo mosdekretimin e ministrit të Brendshëm të propozuar nga Edi Rama. Një gjë është e sigurt, që lëvizja e ardhshme në atë që nuk është lojë shahu, është dhe do të jetë vetë largimi i kryeministrit Rama. Rënia e ministrit të tretë të propozuar nga Rama është dëshmi e krizës së thellë politike dhe morale".



Kreu i PD-së, Lulzim Basha dje në Korçë

KOMPETENCAT

"Presidenti ka kompetencat e tij kushtetuese dhe jam i sigurt që ai do të japë të gjithë aspektin kushtetues për dekretimin apo mosdekretimin e ministrit të Brendshëm, të propozuar nga Edi Rama. Një gjë është e sigurt, që lëvizja e ardhshme në atë që nuk është lojë shahu, është dhe do të jetë vetë largimi i kryeministrit Rama. Rënia e ministrit të tretë të propozuar nga Rama është dëshmi e krizës së thellë politike dhe morale".

Ngjela: Me ministër të Brendshëm një katolik bëheshin tre

Analisti Spartak Ngjela komentoi dje vendimin e Presidentit Ilir Meta për mosdekretimin e ministrit të propozuar për Ministrinë e Brendshme, Sandër Lleshi. Në një postim të bërë publik në "Facebook", ai shprehet se një president nuk ka të drejtë të mos dekretojë një ministër. "Me ministër të Brendshëm një katolik, bëheshin tre katolikë në luftë kundër korrupsionit: prokurorja e përgjithshme, prokurorja e Krimeve të Rënda dhe ministri i Brendshëm. Domethënë tre ultraperëndimorë, në një kohë që Reformën në Drejtësi po e drejton politika perëndimore. Nuk e dimë se kush e ka propozuar ministrin Lleshaj, por për faktin që është trembur Meta, mendohet se e ka propozuar politika gjermane ose ajo amerikane", shprehet avokati Ngjela.



në to dhe mendimin e tyre. "Është e qartë për shqiptarët dhe faktorin ndërkombëtar se sa thellë ka futur rrënjët krimi i organizuar në qeverisjen e vendit. Se si Edi Rama përdori bandat dhe brutalitetin e tyre për të marrë dhe mbajtur pushtetin", u shpreh kreu i PD-së. Për situatën në të cilën gjendet vendi, Basha bëri fajtor kryeministrin Edi Rama, pasi ky i fundit katapultoi banditët nga burgje në poste

deputeti dhe kryetar bashkëish. "Edi Rama ka gjetur mënyra të tjera për t'i bërë bisht dekriminalizimit. E ka kthyer krimin e organizuar në një partner të drejtëpërdrejt të politikanëve të karrierës", deklaroi kreu i opozitës. "Platforma e Partisë Demokratike - tha Basha - sapo të vihet në jetë, do të ndryshojë të ardhmen evropiane të Shqipërisë".

AKUZAT
Kryetari i PD-së, Basha

denoncoi lidhjet, sipas tij, të zyrtarëve të lartë të PS-së me krimin, ndërsa theksoi se, "PS sot është në rrezik shpërbërje për shkak të asaj që quhet organizata kriminale e rilindjes". "Në denoncium marrëdhëniet me politikës dhe krimin. Si Tahiri e transformoi policinë në një aksesori të mafias së drogës, ai është nën hetim megjithëqë përpjekjet titanike që po bëhen që ta shpëtojnë", tha Basha. "Denoncium vëllain e Xhafaqit, e paimagjinueshme që të kemi një ministër të Brendshëm vëllain e një trafikanti droge. Por, falë qëndresës sonë është i delegjitimuar nga detyra e tij. Denoncium lidhjet e Taulant Ballës me kriminelë që marrin tendera në kundërshtim me ligjin dhe bën presion për të liruuar të tjerë kriminelë nga burgju. Ai pret ndjekjen penale nga një prokurorori që pret të dalë nga kapja e krimin", tha kreu i PD-së. Basha përmendi edhe emra të tjerë zyrtarësh të lartë të PS-së si Rrhaman Rraha, Ditmir Bushati etj., dhe i akuzoi për lidhje me krimin. Basha tha se zgjidhja për shpërkputjen e qeverisë nga krimi janë 3 platformat e PD-së: "Ndarja e politikës nga krimi, dekriminalizimi e zgjedhjeve dhe lufta për të çliuar ekonominë nga tenderat korruptive".



Presidenti i Republikës, Ilir Meta dhe kryeministri Edi Rama

Këlliçi në Forumin e të Rinjve të PPE: Alarmante, gjendja e rinisë në Shqipëri

Delegacioni i Forumit Rinor të Partisë Demokratike kryesuar nga Belind Këlliçi mori pjesë në Kongresin e XII të Forumit të Forumit Rinor të Partisë Popullore Europiane YEPP me temë "Revolucioni dixhital, detyrë e Europës për ta udhëhequr atë". Në lidhje me situatën aktuale të rinjve në Shqipëri, z. Këlliçi u shpreh se rritja e tarifave të studimit ka pamundësuar ndjekjen e studimeve për shumë të rinj me rezultate të larta. Tarifat e edukimit janë rritur nga 6 deri në 10 herë, ndërsa varfëria dhe mjerimi janë shtuar. 110 mijë të rinj janë larguar në shifra zyrtare. Mijëra të tjerë janë larguar në 2017-ën, në atë që njihet si emigrimi i heshtur. Ikin, por nuk regjistrohen si azilkërkuës. Mbi 50% e të rinjve në Shqipëri shohin si të ardhme vetëm emigrimin. Largimi i trurit është një kabanë alarmi. Çdo ditë faktohen lidhje të mazhorancës me kriminelë, duke u dhënë atyre dhe tendera publikë, siç është rasti i kreut të grupit parlamentar, Taulant Balla, deklaroi z. Këlliçi. Ai përmendi se PD ka propozuar nismën e vetingut në politikë, e cila mbështetet nga çdo i ri që kërkon një Shqipëri si e gjithë Europa, ku vendimarrja u takon qytetarëve. Në këtë kuadër, z. Këlliçi kërkoi dhe mori mbështetjen e drejtuesve të rinj të YEPP por edhe të EPP për betejën e opozitës shqiptare për ndarjen e politikës nga krimi, për zgjedhje të lira dhe të ndershme. Përpos takimeve me drejtues të forumeve dhe organizatave rinore europiane, z. Këlliçi pati mundësinë të takojë edhe kryetarin e grupit parlamentar të EPP dhe kandidatin për president të Komisionit Europian, z. Manfred Weber. Ai siguroi se do të mbështesë të ardhmen evropiane të Shqipërisë, e cila do të avancojë vetëm me drejtimin e vendit nga PD, siç ka ndodhur deri më sot.





Mosdekretimi i pasuesit të Xhafajt, Kryeministria: Bashkëbisedimi do të vijojë

Letra e Metës për Ramën, 90 minuta kokë më kokë në Presidencë

Presidenti sot zbardh arsyet e refuzimit të Lleshit

Valentina Madani

Një ditë pasi Presidenti Ilir Meta refuzoi Sandër Lleshin për ministër të Brendshëm, kryeministri Edi Rama i shkoi dje në zyrë për t'u njohur me shpjegimet e vendimit të kreut të shtetit. Takimi zgjati për shumë se 90 minuta në selinë e Presidencës, ndërkohe mësohet se kreu i shtetit do të publikojë sot arsyet përse vendosi të mos e firmosë dekretin për ministrin e ri të Brendshëm. Ndaj, Edi Rama iu drejtua vetë zyrës së presidentit, një ditë pasi Meta e njohu atë zyrtarisht me mënyrë shkresore dhe më pas njoftoi mediat se nuk ka krijuar bindje të plotë për t'i dhënë besimin kandidatit të Lleshit si ministër. Me kërkesën e tij, Rama diskutoi me kreun e shtetit për plot 90 minuta. Nuk dihet ç'domethënie ka kjo lëvizje prej "shahisti" e kryeministrit, kur zyrtarisht Meta s'ka dhënë asnjë argument ligjor për mosdekretimin e Sandër Lleshit. Burime nga Presidencë deklaruan se presidenti e ka njoftuar përmes një letre kreun e qeverisë për argumentet e tij, ndërsa arsyet do t'i bëjë publike gjatë ditës së sotme. Pikërisht për këtë letër Meta dhe Rama, siç njoftoi zyra e shtypit të kryeministrit, diskutuan dje në zyrën e kreut të shtetit. Presidencë nuk komunikoi me mediat, ndërsa Kryeministria i mjaftua me një informacion të shkurtër. "Me kërkesë të tij, kryeministri i takua me Presidentin e Republikës për të diskutuar Sandër Lleshin si ministër të Brendshëm", thuhet në reagimin e Kryeministrit.



Presidenti Ilir Meta

PRESIDENCË

Burime nga Presidencë deklaruan se presidenti e ka njoftuar përmes një letre kreun e qeverisë për argumentet e tij, ndërsa publike do t'i bëjë gjatë ditës së sotme. Pikërisht për këtë letër Meta dhe Rama, siç njoftoi zyra e shtypit të z.Rama, diskutuan dje në zyrën e presidentit.

"Kryeministri dështak u gdhi shah mat"

Mosdekretimi i Lleshit, Berisha: Rama, me "bisht ndër shalë" te Meta

Ish-kryeministri Sali Berisha shkruan se kreu i qeverisë, Edi Rama, pasi nuk lejoi kandidatin për ministër të Brendshëm të takojë Metën në Presidencë, shkoi vetë me "bisht ndër shalë", siç shkruan ai. Sipas Berishës, Rama nuk lejoi Lleshin të shkonte në presidencë, por sipas tij hyri me "bisht ndër shalë" në Presidencë. "Këtyj i thonë shah! Me bisht nën shalë në Presidencë! Pardon (të premtën) Kallam Dështaku nuk lejoi këshilltarin Lleshin të shkojë në Presidencë, pra nuk lejoi gjeneralin të paraqitet të kryekomandantit. Sipas mediaeve, kërkesës së presidentit, kryekomandantit për takim, gjenerali iu përgjigji ushtarakisht: 'Do të vij si ministër pasi të më dekretoni'. Me terma të tjera, në mënyrë si ministër, të njoh për president, përndryshe nuk të njoh as si kryekomandant! Mbrëmë (të shtunën) Kallam Dështaku i dërgoi mesazh deputetëve të tij: 'No comment' për



rrëzimin e Lleshit. Politika është shah. Sot (dje) Kallam Dështaku u gdhi mat! Fitimtar, por me bisht nën shalë hyri në Presidencë. Ruçi thotë: Këtyj i thonë shah-mat o Kallam Dështak!", shprehet ish-kryeministri Sali Berisha. Berisha thotë se në takimin 2 orë me Metën, kryeministri Edi Rama doli si "pentito" nga Presidencë. "Ngjarje dite: Kallam Dështaku në Presidencë! Shkoi si trimosh me bisht nën shalë. Qëndroi aty dy orë. Aty jo që harroi Sandrin, por doli si pentito, shqip si i dhj...! Siç listë, ju rroftë timonieri, shahisti i madh Kallam Dështaku!", shprehet z.Berisha.

dilema që vetë palët kanë zgjedhur të jenë të tilla, priten të sqarohen në fillim të javës kur përfundon edhe afati i tetë kushtetues prej 10 ditësh që parlamenti të votojë ose jo dekretin e Presidentit për shkarkimin e ministrin të dorëhequr, Fatmir Xhafaj. Dy ditë më parë kryeministri Rama iu është drejtuar me një mesazh edhe deputetëve, të cilëve u kërkoi të mos lëshojnë asnjë koment për vullnetin e treguar nga kreu i shtetit. Mes të tjerash, Rama shkroi se shumica e ka për detyrë t'i dalë për

zot Kushtetutës dhe qytetarëve, ndërsa politikën e cilëson si një lojë shahu, e cila nuk duhet harruar sipas Ramës. "Lutem asnjë lloj koment askush për vendimin e presidentit! Në jemi shumica dhe kemi detyrën t'u dalim zot njerezëve, vendit, Kushtetutës me maturi dhe vendosmëri. Politika është shah, mos e harroni", thuhet në mesazhin e kryeministrit, drejtuar deputetëve. Zyra e shtypit njoftoi ditën e shtunë se Presidenti Meta nuk e ka krijuar bindjen për të dekretuar Lleshin si min-

istër të ri. "Presidenti i Republikës, Ilir Meta, nuk ka krijuar bindjen e plotë për t'i dhënë besimin kandidatit të z.Sandër Lleshaj si ministër të Brendshëm", thuhet në njoftimin e shkurtër të Presidencës. Një javë më parë, pikërisht të shtunën, më 27 tetor, Rama njoftoi se kishte emëruar pas dorëheqjes së Fatmir Xhafajt, gjeneral Sandër Lleshin në postin e ministrin të Brendshëm. Pak orë pas dorëheqjes, Meta dekretoi shkarkimin e Xhafajt, por jo edhe emërimin e Sandër Lleshit.

KRYEMINISTRIA

"Me kërkesë të tij, kryeministri i takua me Presidentin e Republikës për të diskutuar rreth përmbajtjes së letres së këtyj të fundit mbi propozimin për dekretimin e gjeneral Sandër Lleshit si ministër të Brendshëm", thuhet në reagimin e Kryeministrit.



"Lleshi", Patozi: Pse Meta na përfaqëson më shumë se kushdo tjetër...

Ish-kreu i grupit të PD-së, Astrit Patozi komentoi dje vendimin e fundit të presidentit për të mos dekretuar Sandër Lleshin si ministër të Brendshëm. Patozi thekson në "Facebook" se me këtë vendim, Meta na përfaqëson më shumë se kushdo tjetër. Por për Patozin, vendimi i Metës i kapi të papërgatitur dhe i ka shokuar të gjithë. "Por mbi të gjitha, duhet të pranohet se për ta, Kushtetuta është si një vëllim me poezi, që çdo president që vjen e lexon si të dojë vetë, sepse ndryshe i bie që Bujar Nishani vjet, kur tha se, me gjithë dëshirën e tij nuk e rrëzonte dot propozimin e kryeministrit, ka qenë në shërbim të Edi Ramës. Kurse të tjerët në qeveri po e konsiderojnë si një gjë më që i ka pllakosur papritur kombit dhe po përparojnë për hakmarrjen finale. Përveç Erion Braçes, që foli përpara dhe pa ngritur dorën për të marrë leje, të tjerët po shtrëngojnë dhëmbët me zor që të mos e shajnë me libër shpie presidentin, për të cilin mendojnë se vetëm i tyre nuk është. A thua se nuk ishin të njëjtët që përpara një viti mblodhën firmat, u vunë në rresht dhe votuan në parlament për ta çuar Ilir Metën në fronin e kreut të shtetit", shkruan Patozi.

SITUATA POLITIKE

INTERVISTA

Ish-ambasadori: Negociatat me BE u shtynë, vazhdimi i bisedimeve me Athinën s'ka më interes

Minarolli: Asnjë marrëveshje me Greqinë, pa hequr ligjin e luftës

"Çamët të lejohen kërkojnë të drejtën e pronësisë"

Valentina Madani

Vili Minarolli, tashmë i shkëputur nga jeta politike dhe ajo diplomatike, ndërkohë që vitet e fundit i është përkushtuar publicistikës përmes romanit "Trafiqantët", paralajmëroi dy vite më parë "Kërcënime dhe vrasje, hakmarrje dhe pushtet, tradhti dhe para". Z.Minarolli përmes "Gazeta Shqiptare" shpreh kritik për situatën në vend, teksa thotë se i ka njohur ata që erdhën në pushtet përmes vjedhjes së votës me paratë e kirit. Ish-drejtesi i lartë i PD-së vlerëson aksionin e opozitës për shkëputjen e lidhjeve të krimtike me politikën, por lidhshpilit të saj i kujton se jo revoltat, por vota e lirë e ndryshon qeverisjen. Kreun e PD-së Lulzim Basha e quan lider vizionar, por sipas tij ka nevojë për përvojën dhe këshillat e Sali Berishës. Ish-ambasadori i Shqipërisë në Greqi flet edhe për marrëdhëniet me Greqinë, teksa këshillon qeverinë shqiptare se nuk duhet të bëjë asnjë marrëveshje me Athinën sa kohë Greqia mban si "gozhdë" ligjin absurd të luftës.

Z.Minarolli, si është të qëndros larg jetës politike dhe diplomatike pikërisht tani që pozita dhe opozita "ziejnë" nga konfliktualiteti i krijuar mes tyre?

Për mua është kreu i natyrshme dhe normale. Si politika, ashtu edhe diplomacia janë në një farë mënyre profesione në shërbim të një force politike apo të një interesi më të gjërë dhe si në çdo profesion, vjen një moment që e gjykon se puna jote nuk i sjell ndonjë doli këtyre interesave dhe tërhiqet. Por kuptohet se pas një jete aktive në politikë dhe diplomaci, nuk mund të qëndrosh indiferent kundrejt zhvillimeve të mëvonshme, që sigurisht duhet t'i gjykojë të ndërvarura me rrethanat dhe konjunkturën e reja të krijuara qoftë brenda vendit, qoftë në arenën ndërkombëtare. Edhe pse duke mos qenë protagonist nuk mund të jesh indiferent



Ish-ambasadori i Shqipërisë në Greqi, Vili Minarolli

me gjykimet apo opinionet thjesht si qytetar për të shprehur shqetësimet për të ardhmen e vendit dhe zhvillimet demokratike në vend.

Si ish-ambasador i Shqipërisë në Greqi, si i gjykon ngjarjet e Bularatit dhe a mendoni se cenon marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Greqisë?

Unë gjykoj se ngjarja e Bularatit nuk ka të bëjë me politikën shtetërore të shtetit grek dhe si e tillë nuk ka e nuk duhet të ketë asnjë ndikim në marrëdhëniet midis dy shteteve tona. Unë vlerësoj mendimin e shprehur nga zoti Pangallos dhe pas tij, kjo çështje duhet të qihet e mbyllur.

Gjatë kohës që ju ishit ambasador, a jeni ndeshur me veprime të qarqeve ekstremiste dhe a kanë pasur mbështetje publike apo politike?

Sigurisht, në detyrën time në Greqi, unë jam ndeshur me veprime të këtyre qarqeve ekstremiste, që e shikojnë këtë mënyrë veprimi si protagonist politik, por që nuk kanë gjetur mbështetje as në opinionin publik grek dhe as në atë politik. Ashtu si normalisht nuk duhet të kenë jehonë as në shtypin dhe median tonë.

Prej 10 vitesh çështja e kufirit detar vazhdon të jetë e pazgjidhur, kjo pasi marrëveshja e 2009-ës u shfuqizua nga Gjykata Kushtetuese. Ndërkohë, qeveria "Rama" po negocion për një

marrëveshje të re. Pse kaq i vështirë negociimi i një marrëveshjeje të tillë?

Unë kam qenë në detyrë në Athinë kur u bisedua për kufirin detar, po nuk kam qenë pjesë në bisedime. Në atë kohë, si edhe për marrëveshje të tjera ndërshtetërore, kjo nuk krijonte ndonjë ndjeshmëri tek publiku dhe nuk kishte interes për transparencë për atë që bisedohej. Di që delegacioni shqiptar ishte i përbërë nga njerëz profesionistë të fushave të tyre dhe për disa që i njihja personalisht kisha respekt për integritetin dhe përgjegjëshmërinë e tyre, në dobi të interesave kombëtare. Asnjë prej tyre nuk besoja se mund të futet në pazare "shitje-blerje", ashtu siç doli së fundmi nga ish-ministri Korcias. Por kisha informacion se për këtë problem me efekte kombëtare dhe ndërkombëtare ne nuk e kishim përvojën dhe ekspertizën e domosdoshme.


Realisht a lu fal det Greqisë nga territori shqiptar?

Unë edhe sot nuk e di që Gjykata Kushtetuese bëri matje dhe konstatoi që i ishte "falur" det Greqisë me marrëveshjen e 2009, por di që me të drejtë e zhvlerësoi marrëveshjen si antikushtetuese nga ana procedurale, për shkak se delegacioni ynë nuk kishte marrë miratimin e presidentit, kërkesë kjo kushtetuese. Për mendimin tim, marrëveshja në vetvete paraqet vështirësi për shkak të veçorive specifike fizike të

terrenit dhe pastaj të metodologjisë sipas të cilës do të procedohej. Për shkak të ndjeshmërisë që ka krijuar në opinionin publik dhe politik dhe për shkak të kufizimeve që jep në vendimin e GJK, marrëveshja e re kërkon informacion dhe transparencë të plotë, së pari për Presidentin e Republikës dhe forcat politike, pastaj edhe për publikun. Kjo edhe tani ka munguar nga ana jonë dhe ai pak informacion që është mësuar, ka ardhur nga pala greke, i saktë apo i deformuar.

Megjithatë, negociatat mes Shqipërisë dhe Greqisë janë të bllokua...

Po, në fazën aktuale negociatat janë bllokua dhe me të drejtë. Për palën tonë mendoj se vazhdimi i bisedimeve nuk ka interes tashmë që u shtynë afatet për hapjen e negociatave me BE-së, për të cilën vota e palës greke kushtëzohej me këtë marrëveshje dhe me të tjerat, siç ishte "mbyllja" e çështjes came apo hapja e varrezave të reja greke në jug të vendit. Unë kam menduar dhe këtë mendim e kam gjetur edhe tek bashkëbisedues ndërkombëtarë, se Marrëveshja e Miqësisë dhe Bashkëpunimit midis dy vendeve tona e vitit 1995, ku edhe çështja came trajtohej se çështje e pronave të banorëve shqiptarë në Greqi, automatikisht e abrogojti ligjin e luftës midis dy vendeve. Gjatë gatit pesë viteve që shërbeva në atë vend, në të gjitha bisedimet qoftë diplo-



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, gjatë një mbledhjeje me kryesinë e partisë

matike, qoftë të niveleve më të larta shtetërore, asnjëherë nuk u përmend ligji i luftës dhe të dyja palët vazhduam marrëdhëniet shumë të mira në interes reciprok. Tani, ndoshta edhe si rezultat i politikës amatorese dhe infantile të qeverisë sonë, problemi i ligjit të luftës po përdoret si një kusht nga pala greke për të kërkuar lëshime dhe detyrime. Kjo më ka bërë të gjykoj se me palën greke nuk mund dhe nuk duhet të ulemi për asnjë marrëveshje, pa hequr nga ata që e mbajnë si "gozhdë"

të qytetarëve shqiptarë në Greqi dhe anasjelltas. Popullsia çame u dëbua me dhunë nga trojet dhe shtëpitë e tyre me pretendimin se kishin qenë bashkëpunëtorë të pushtuesve. Në qoftë se ka pasur disa persona të tillë nga kjo popullsi, ka ligje ndërkombëtare dhe kombëtare që veprojnë ndaj tyre, po nuk mund të dënohet një popullsi të tërë, që pasi masakrove edhe fëmijët e sapolindur, i përzure me dhunë nga shtëpitë e tyre. Kjo i përket historisë dhe është detyrë e poli-

NEGOCIATAT

"Për palën tonë, mendoj se vazhdimi i bisedimeve nuk ka interes tashmë që u shtynë afatet për hapjen e negociatave me BE-së, për të cilën vota e palës greke kushtëzohej me këtë marrëveshje dhe me të tjerat, siç ishte "mbyllja" e çështjes came apo hapja e varrezave të reja greke në jug të vendit", theksoi Z.Minarolli.

ligjin absurd të luftës midis dy vendeve. Si mund të bisedohet për kufij detarë apo tokësorë midis dy vendeve, që janë në gjendje lufte? Dy vendet tona janë aleatë në NATO dhe secili vend ka detyrim të mbrojtjes tjetrit kur i cenohet integriteti territorial nga një palë e tretë. Dhe unë gjykoj se ky është një problem politik dhe diplomatik i shtetit shqiptar për ta shtruar në organizma ndërkombëtare, ku bëjnë pjesë të dyja vendet tona, në qoftë se nuk zgjidhet nga pala greke.

A është e vërtetë që çdo qeveri shqiptare e shmag çështjen came sa herë që bisedohet me Athinën zyrtare? Çfarë e bën të pazgjidhshme këtë çështje?

Kur themi çështja came, unë besoj se nuk ka të bëjë me ndonjë pretendim territorial të Shqipërisë ndaj shtetit grek. Ashtu siç është shkruar edhe në Traktatin e Miqësisë, ajo ka të bëjë me kthimin e pronave

tikës të korigjiojë. Tani në bazë të konventave ndërkombëtare, ata gëzojnë të drejtën e pronësisë. Po si mund ta fitojnë këtë të drejtë kur ata nuk lejohen të shikojnë të kërkojnë pronat e tyre, për shkak të një ligji absurd të sekuestros dhe të një tjetri po aq absurd, siç është ligji i luftës? Pra, këtu duhet të fillohet të hiqet ligji i luftës dhe pastaj të lejohen çamët të shikojnë të kërkojnë të drejtën e pronësisë në qoftë se kanë dokumentet ose të shikojnë t'i gjejnë në arkivat dhe kadastrat greke, ashtu siç mund të bëjnë edhe qytetarët grekë për pronat e tyre në Shqipëri. Unë jam dëshmitar i përpjekjeve të paimagjinueshme që bëri politika shqiptare '92-97, por edhe më tej për pavarësinë e Kosovës në faktorin ndërkombëtar. E njëjta gjë duhet bërë edhe për pronat e popullsisë çame, meqenëse shteti grek e bën veshin e shurdhët.

Të ndalemi tek aktualiteti në vend. Kur shkruat dy



vjet më parë librin "Trafikantët", a e kishit menduar se situata me krimin veçse do të përkeqësohej për shkak të ligjeve me pushtetin? A i njihnit këta që po qeverisin sot shqiptarët?

Sigurisht, situata që është sot u duk që me veprimet që ndoqi ish-opozita e majtë për të ardhur në pushtet. Çdo opozitë për të ardhur në pushtet, duhet të ngjallë shpresën te votuesit se do të qeverisë më mirë. Dhe bën premtime të mbështetura në një program realist, duke vënë në dukje defektet e qeverisjes aktuale. Socialistët shqiptarë të drejtuar nga Rama për disa vjet me radhë provuan forma të dhunshme të rrëzimit të qeverisë dhe kur nuk patën sukses, u drejtuan kimit dhe bënë marrëveshje me të. Dhe premtuan pa asnjë program dhe pa asnjë skrupull, duke mashtuar e gënjyer si "Bijtë e etërve" që ishin. Kur shkruajta "Trafikantët", i njihja kush ishin ata që na qeverisnin, e dija si erdhën në pushtet dhe shumë prej lidhjeve të tyre me krimin e organizuar, që po qeveriste vendin tashmë. Ashtu siç nuk më mungonin edhe disa informacione nga jashtë vendit.

Çfarë informacionesh...?
Unë nuk njoh në eksperiencën botërore një shtet që bashkëqeveris me krimin e organizuar në dem të interesave të qytetarëve të vet, por edhe duke u bërë qesharak dhe i pabesueshëm në arenën ndërkombëtare. Edhe në ato vende ku krimi ka qenë shumë i fortë, që zotëronte zona e krahina të tëra, jo vetëm që nuk ka pasur bashkëpunëtorë qeverinë, por në të kundërtën është goditur nga qeveria e vendit. Tek ne bashkëpunimi me krimin është parë si mundësi për të qenë në pushtet dhe për të vjedhur pasurinë kombëtare duke varfëruar popullin tënd.

Kjo është qeveria jonë sot. U largua ministri i parë i Brendshëm, si njeriu që kanabizoi vendin dhe inkriminoi Policinë e Shtetit (sigurisht jo pa dijeninë dhe miratimin e bosit të tij) si kërkesë e ndërkombëtarëve dhe u caktua të mblidhte votat në fushatë megenjëse e kishte të ngritur infrastrukturën kriminale. Tjetri këto ditë u largua dhe ka hipoteza në lidhje me largimin e tij, por asnjëra për arsye morale apo integriteti. Ai ndërmoi disa aksione, sigurisht me dijeninë, bashkëpunimin dhe kërkesën e partnerëve ndërkombëtarë, duke goditur disa nga bandat më të zëshme të vendit, në veri dhe Shqipërinë e Mesme, duke prishur skemën e kryeministrit si rezervatë votash. Këto banda ishin sigurie e kreut të Rilindjes për të fituar zgjedhjet. Me anë të tyre, ai siguronte votat me blerje, me shantazhe e krime, me lëshime karshi krimeve etj. Po për këtë qëllim i ka edhe disa kryetarë bashkish, që i mban për më shumë se dhjetë vjet, edhe pse i njëjti mirë zulumet e tyre. Sa kohë kryetari i Bashkisë të Durrësit do të ndjehet i fuqishëm si hambar për votat e kryeministrit, edhe pse tashmë është i provuar për krime elektorale, ai do të jetë i paprekshëm. Xhafaj me arrestimet e bandave në Shkodër, Lezhë, Krujë apo Durrës (gjithnjë për pjesëmarrjen e tyre në krimin e organizuar ndërkombëtar) irrezikoi qeverisjen Rilindjes dhe ai e largoi. Për këtë tjetrin që ka propozuar dhe që ia refuzoi Presidenti, ishte i bindur që është "pa gojë, pa sy e pa veshë" dhe kjo është e mjaftueshme për të qenë ministër i Brendshëm në këtë vend tashmë të kapur peng nga krimi.

Opozita e drejtuar nga Lulzim Basha ka nisur një betejë për shkëputjen e

Ish-kreu demokrat: Xhafaj iku pasi prishi skemën e Ramës për blerjen e votave

Minarolli: Jo revolta, vota e lirë ndryshon qeverisjen

"Basha vizionar, ka nevojë për përvojën e Berishës"

ÇËSHITJA ÇAME

"Të hiqet ligji i luftës dhe pastaj të lejohen çamët të shkojnë të kërkojnë të drejtën e pronësishë në qoftë se kanë dokumentet, ose të shkojnë t'i gjejnë në arkivat dhe kadastrat greke, ashtu siç mund të bëjnë edhe qytetarët grekë për pronat e tyre në Shqipëri", theksoi ish-diplomati shqiptar.



Ish-deputeti i PD-së, Vili Minarolli

DORËHEQJA

"Xhafaj ndërmoi disa aksione, sigurisht me dijeninë, bashkëpunimin dhe kërkesën e partnerëve ndërkombëtarë, duke goditur disa nga bandat më të zëshme të vendit, në veri dhe Shqipërinë e Mesme, duke prishur skemën e kryeministrit si rezervatë votash. Këto banda ishin sigurie e kreut të Rilindjes për të fituar zgjedhjet".

KUSH ËSHTË VILI MINAROLLI

Vili Minarolli lindi në Elbasan, më 8 gusht 1944. Më 1962 mbaroi gjimnazin "Petro Nini Luarasi" në Tiranë. Më 1966 u diplomua në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dega Matematikë. Për shumë vjet punoi mësues në Berat e Kuçovë, e më pas punonjës shkencor në Institutin e Studimeve Pedagogjike dhe pedagog në Universitetin e Tiranës. Më 1968 mori titullin "Doktor i Shkencave". Më 1992 u emërua drejtor në Ministrinë e Arsimit, më 1993 në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe i Ngarkuar me Punë në ambasadën shqiptare në Beograd. Më 1995 drejtor i Europës në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Nga 1996 u angazhua në politikë si një nga drejtuesit kryesor të Partisë Demokratike dhe deputet në tri legjislatura. Më 2005 u emërua ambasador në Athinë, ndërsa në 2010 në Austri. Në nëntor 2013 u largua me dëshirë nga shërbimi diplomatik dhe nga të gjitha funksionet shtetërore e partiake.

krimin nga politika. Pse kaq i sulmuar kreu i PD-së edhe nga vet brenda partisë?

Për mendimin tim, Lulzim Basha me ekipin e tij është një drejtues vizionar. Ai mori drejtimin e PD-së në një kohë kur besimi i votuesve tek forca e tij politike ishte në kuota shumë të ulëta. Pa gjykar arsyet, Basha e orientoi partinë jo në betejë për të ardhur në pushtet, por për të rritur besimin dhe shpresën te kjo forcë politike. Duke e krahasuar me situatën e PD-së pas vitit 1997, të cilën e njoh mirë, them se situata e PD-së pas 2013-ës ishte krejt tjetër. Dhe betejat politike që ndërmoi PD-ja nën drejtimin e zotit Basha ishin të duhurat. Duhet treguar dhe bindur shqiptarët se u deformuan parimet e demokracisë të ndryshimit të pushtetit me votë të lirë dhe u vërtetua se ne kishim një parlament të mbushur me njerëz të ardhur nga bota e krimin. Jemi i vetmi vend në rruzull

që nuk mund të rritet shpresa e shqiptarëve për një qeverisje në shërbim të interesave të tij. Unë nuk gjykoj se tashmë është emergjent ligji elektorale, sesa këthimi i shqiptarëve te vota e lirë. Dhe për këtë mbështes plotësisht aksionet e politikës që ndjek opozita e drejtuar nga zoti Basha.

Si e shikoni Sali Berishën të tërhequr nga vendimmarrja e PD-së? Largimi i tij nga drejtimi i PD e ndihmoi apo e dëmtoi të djathtët, që realisht pësoi humbje të mëvonshme?

Sali Berisha me vepërimitarinë e tij e ka treguar veten se është burrë shteti, si shumë politikane të tjerë në botë. Ai u largua vetë nga drejtimi, sepse forca që drejtoi humbi besimin e elektoratit, por jo besimin ndaj tij. Unë e gjykoj se liderhipi i PD-së ka nevojë për përvojën dhe këshillat e tij, edhe pse ndoshta nuk ka fuqi vendimmarrëse. Ashtu siç ka nevojë edhe faktori ndërkombëtar ta ketë si interlokutor në çështje kombëtare dhe rajonale. PD, siç po provohet çdo ditë, nuk arriti rezultatet e pritshme në zgjedhjet e kaluara, jo se në drejtim të saj nuk ishte Berisha, por se vota u vodh, u ble, u tjetërsua me ndihmën e krimin dhe të kriminelëve.

Si mund të rrezohet qeveria "Rama"? Besoni se revolta popullore

janë zgjidhje, siç kanë deklaruar disa nga eksponentët e së djathtës?

Edhe në çështjen e marrjes së pushtetit është një nga dallimet thelbësore midis të majtës dhe të djathtës. Marrja e pushtetit me dhunë është në thelbin e filozofisë të së majtës regressive dhe jo si një forcë liberale. "Bijtë e etërve" nuk ndryshojnë nga trashëgimia e tyre. E djathta në këtë drejtim, edhe PD si një forcë që vendosi demokracinë dhe pluralizmin në Shqipëri, e shikon ndryshimin e pushtetit vetëm nëpërmjet vullnetit të lirë të qytetarëve të shprehur me votë. Prandaj në këto momente kaq të veçanta për të ardhmen e vendit, misioni i opozitës shqiptare dhe në veçanti i PD-së nuk duhet të jetë marrja e pushtetit si qëllim në vetvetë, por ndryshimi i pushtetit nëpërmjet votës të lirë të qytetarëve. Dhe nuk mund të arrihet pa shkëputur politikën nga krimi, që njerëzit të shprehin lirshëm vullnetin e tyre për qeverinë në shërbim të tyre. Revolta dhe protestat popullore janë të drejta demokratike të çdo qytetari. Ata mund të duhen të protestojnë dhe të shprehin revoltën e tyre ndaj padrejtësive të pushtetit, ndaj rritjes së taksave, rritjes të papunësisë, arrogancës të shtetit... por jo si mjet për të ndryshuar qeverisjen. Revolta mund t'i heqin të drejtën e qeverisjes një pushteti që i ka mashtuar për t'u marrë votat, por do të jenë gjithnjë zgjedhjet dhe vota e lirë, ajo që do të ndryshojë qeverisjen.

VRASJA NE BLOK PROCESI

Biznesmeni u plagos pas sherrit në Bllok. Artan Gjermeni kërkon prova të tjera

Gjykata, "shuplakë" prokurorisë: Masa e Ervis Martinajt, 30 ditë burg "Ekspertimi kimik, nuk ka qëlluar me armë"

Pas kërkesës së prokurorisë, gjykata ka vendosur 30 ditë burg të tjera për Ervis Martinajn, një nga protagonistët e përfshirë në masakrën e 4 tetorit në ish-Bllok. Gjykatësi Artan Gjermeni "rrëzoi" dy nga provat e prokurorisë, ato për komunikimet telefonike dhe ekspertimin kimik, duke e nxitur organin helmor të kërkohjeve prova të tjera. Nëse pas 30 ditëve këto prova të reja nuk sigurohen, atëherë biznesmeni Ervis Martinaj do të dalë i lirë. Kujtojmë se dje Martinajt i mbaronte afati për masën e sigurisë prej 30 ditësh qëndrimi në burg.



Ervis Martinaj

Gjykata e Krimeve të Rënda ka shtyrë me 30 ditë burg masën e arrestit për Ervis Martinajn, i cili u përfshi në përplasjen me armë zjarri në zonën e Bllokut. Gjykatësi Artan Gjermeni ka lexuar akuzat për Martinajn, pastrim e produkteve të veprës penale, falsifikim dokumentesh, fshehje e pasurisë dhe organizim i lojërave të paligjshme. Janë këto akuzat të ngritura nga prokuroria për Martinajn dhe pritet që 30 ditët e tjera të sigurohen prova të reja për të kërkuar masën arrest me burg. Gjykatësi rilexoi në vendimin e tij përgjimet nga telefoni i Martinajt, ku bisedon me miqtë e tij, bisedat para përplasjes me armë. Pas ekspertimit kimik të bërë, gjykata konstatoi se kishte gabim. Nuk u konstatua mbetje të nitrive në duart e Martinajt. Sipas aktit të ekspertimit të celularit, karta SIM nuk korrespondon me telefonat që i janë bërë Martinajt", raportoi gazetari Klajdi Bodlli për "Balkanëb".

Prokuroria siguroi prova të reja për vrasjen në ish-Bllok, të cilat rëndojnë pozitën e Ervis Martinajt, aktualisht në burg. Prokuroria pretendoi se kishte zbuluar biseda në aplikacionet "Ehatsapp" dhe "Telegram" të Martinajt me miqtë e tij pak minu-

ta para ngjarjes ku mbeti i vrarë Fabian Gaxha. E pikërisht me viktimën, por edhe disa miq të tjerë duket se ka komunikuar 36-vjeçari Martinaj. Më herët, gazetaria Klodiana Lala duke cituar burime nga prokuroria, raportoi se kur Martinaj është paraqitur në lokalit "Monopol", iu ka kërkuar miqtë të afrosheshin dhe të paraqiten aty të pajisur me armë. Pra, sipas prokurorisë nuk ka qenë takim i rastësishëm siç ka thënë Martinaj në dëshminë e tij dhe shërrit nuk ka pasur si shkak ngacmimet e këngëtares Elvana Gjata, por konflikte të mëparshme. Kjo është një provë e re, por ekspertiza e telefonit mund të nxjerrë të tjera detaje. Ndërkohë, në bazë të provave balistike, rezultoi se Martinaj nuk ka qëlluar me armë mbremjen kur ndodhi ngjarja.

KRONOLOGJIA E NGJARJES
Rreth orës 21:26:58, në dyqan hyjnë shtetasi Ervis Martinaj, i shoqëruar nga shtetasi Eljon Hato dhe një person ende i paidentifikuar.

Rreth orës 21:28:08 në dyqan futet një person ende i paidentifikuar dhe direkt pas tij, vjen viktima Fabian Gaxha.

Rreth orës 21:28:36, nga dyqani duket që del shtetasi Ardi B. i cili largohet

duke dalë nga shkallët e dyqan "Monopol".

Rreth orës 21:29:16, nga dyqani largohet me vrap personi i paidentifikuar që shoqëron shtetasin Ervis Martinaj.

Rreth orës 21:29:19, nga dyqani largohet me vrap shtetasi Ajaks B.

Rreth orës 21:30:36, nga brenda dyqanit dalin në rrjedhë kronologjike shtetasit Mevjol Bilo, Ervin Mata, Geldo Hoti dhe Fabio Allushi.

Rreth orës 21:29:48, nga dera e dyqanit ka dalë Redi Popesku dhe pas tij ka qenë Ervis Martinaj.

Rreth orës 21:30:27, nga dera e dyqanit ka dalë personi i paidentifikuar, që hyn disa sekonda përpara viktimës Fabian Gaxha.


Rreth orës 21:30:30, në dyqan hyjnë përsëri Redi Popesku, ku duhet theksuar se dera në hyrjen e dyqanit është e hapur dhe i shtrirë përtoke duke rënkuar është i plagosuri rënd Eljon Hato.

Rreth orës 21:31:10, Redi Popesku ka dalë përsëri nga dyqani.

Rreth orës 21:34:41, i plagosuri rënd Eljon Hato, duke u zvarritur ka arritur të kalojë derën e dyqanit dhe aty vjen e merr një person, i cili është ende i paidentifikuar. Ky person bën transportimin e Eljonit duke e mbajtur në krahë dhe kalon në trotuar të "KFC", dhe më pas i humbin objektivit të kamerës së "KFC".

SEKUESTRO ARMES SE KOMANDOS

Në zbatim të urdhrimit të prokurorit është sekuestruar arma e shërbimit e shtetasit Mevjol Bilo, konkretisht arma tip pistoletë 'PX4, Storm', me nr. 3551B, e kompanisë "Beretta", me 12 (dymbëdhjetë fishekë) në Repartin e Forcave Speciale 1050 në Zall-Herr Tiranë.




Vendi ku ndodhi ngjarja

Kamerat në Bllok, shërrit dhe vrasja ndodhën për 60 sekonda

"Elvana do t'i merrte çelësin Matës, ndaloi një 'G Class' dhe e ngacmoi"

Vrasja e Fabian Gaxhës dhe plagosja e të tjerëve në shërr ka zgjatur rreth 1 minutë. Prokuroria ka zbardhur dinamikën e përplasjes në zonën e Bllokut në 4 tetor dhe ka zbardhur kamerat e sigurisë së bizneseve në zonë. Sipas prokurorëve rezultoi se, "e gjitha ngjarja, duke përfshirë konfliktin fizik dhe më pas atë me armë ndodh brenda një harku kohor rreth 60 sekonda, duke marrë në konsideratë faktin e daljes nga ambientet e lokalit të personave të përfshirë në ngjarje". "Gazeta Shqiptare" zbardh sot të gjithë kronologjinë e ngjarjes, minutë pas minute, sipas dosjes së prokurorisë.

KRONOLOGJIA
Është bërë këqyrja e pamjeve filmike të subjekteve dyqan "Monopol" dhe "KFC", ku nga krahasimi edhe me aktet e tjera procedurale, ka rezultuar se: Më datë 04.10.2018 ora 18:54, shtetasit Ervin Mata, Geldo Hoti (Liçaj), Fabio Allushi, Mevjol Bilo kanë hyrë brenda në ambientet e dyqan "Monopol". Në këto momente ka hyrë edhe një shtetase e identifikuar dhe pyetur nga ana jonë, shtetasja



E. L., e cila deklaroi se ka qenë me qëllim të shikonte disa artikuj që pronari Redi Popesku tregonte dhe largohet rreth orës 21:21:07.

Rreth orës 20:37, nga dyqan "Monopol" ka dalë shtetasi Ervin Mata, i cili është duke folur në telefon dhe sipas deklaratimit të shtetasit Redi Popesku, Ervini del jashtë për t'u takuar me të fejuarën e tij, shtetasen Elvana Gjata, për të shkëmbyer një çelës shtëpie. Ajo e kishte parkuar automjetin e saj në rresht për dy. Në momentin që Ervini ka qenë duke bashkëbiseduar me të fejuarën, në rresht të tretë, ka kaluar një automjet dhe personi/personat që kanë qenë brenda tij kanë ngacmuar të fejuarën e Ervinit. Ky automjet ka vazhduar qarkullimin drejt "KFC" dhe për një moment ndalon dhe kryen

manovrën e ecjes mbrapa dhe pasi qëndron aty afrohet shtetasi Ervin Mata, pamje të cilat janë regjistruar nga DVR e subjektit "KFC".

Rreth 10 sekonda më pas, te vendi ku automjeti kishte ndaluar dhe bisedonte me Ervin Matën, afrohet edhe shtetasi Mevjol Bilo dhe bisedojnë me personin/personat që ndodhen brenda në automjet, ku vërehet se Ervini e shtyn me dorë shtetasin Mevjol Bilo, me qëllimin për ta larguar. Po sipas deklaratimit të Redi Popeskut, ku shprehet se ka dëgjuar nga Ervini se personi që ishte në drejtim të automjetit ishte ish-shoku i ngushtë i tij dhe kjo duket edhe nga pamjet filmike, ku Ervini largon Mevjolin me qëllimin për t'u sqaruar vetë, megjithëse Mevjoli nuk largohet, por i qëndron aty pranë. Pasi shkëmbejnë disa fjalë, rreth 1 minutë më pas Ervini me Mevjolin largohet në drejtim të dyqan "Monopol", ndërsa automjeti vazhdon në drejtim të "Sky Tower". Automjeti në dukje është i markës "Mercedes Benz", tipi "G-Class", ngjyra e zezë me disqe të zeza, por pa targë të identifikueshme.



Dy dëshmitë e Redi Popesku: Mata tha "e kam shok" për atë që ngacmoi Elvanën

Pronari i lokalit ku ndodhi krimi: Sherri ndodhi për Elvana Gjatën

Popesku: Ervis Martinaj tha "mos, mos, mos"

Pronari i lokalit ku ndodhi ngjarja në Bllok, Redi Popesku ka dëshmuar për prokurorët dinamiken e ngjarjes. Sipas Popeskut, këngëtarja Elvana Gjata u ngacmuar në sy të Ervin Matës, por vetë Mata i kishte thënë grupit të vet që personi që kish bërë ngacmimin ishte "shok i ngushtë i tij" dhe prandaj për momentin sherri jashtë lokalit ishte evituar. Popesku ka dhënë dy dëshmi para prokurorëve, të cilat do t'i lexoni më poshtë:



Redi Popesku

DEKLARIMI I PARE I POPESKUT

I është marrë deklaraminë cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit, shtetasit Redi Popesku, i cili është administrator i subjektit "Red Diamond" sh.p.k, që ka në pronësi dyqanin ku ka ndodhur ngjarja. Ky shtetas deklaroi se më datë 04.10.2018, rreth orës 18.00, ka shkuar në dyqanin e tij shtetas Ervin Mata, pronar i hotelit "Victoria", i cili shoqërohej me katër persona të tjerë dhe pasi kanë parë në vitrinë, janë ulur në tavolinë ku Redi u ka shërbyer pije alkoolike.

Më pas Ervin Mata së bashku me një person tjetër me emrin Joli (mbiemrin nuk ia dinte) i cili është oficer në Zall-Herr kanë dalë jashtë, ku Ervini është takuar me të dashurën e tij, shtetasin Elvana Gjata. Kur është kthyer sërish në dyqan së bashku me Jolin ka klient, që shoqërohej nga dy persona të tjerë dhe i ka thënë se do takonte Ervin Matën që ndodhej në dyqan dhe së bashku me dy persona të tjerë është takuar me Ervinin ku janë ulur veç në fund të banakut. Sipas Redit, dy personat që shoqëronin Ervis Martinajn janë kapur me shtetasin me emrin Joli, duke i thënë që pse po shikon dhe në këtë moment kanë ardhur dy persona nga jashtë, njëri i veshur me bluzë të errët me kapuç, trup i gjatë, me xhinse, i cili së bashku me personin tjetër që e shoqëronte filluan të shanin dhe të godisnin me grushte Jolin, oficerin e Zall-Herit

dhe personat e tjerë që ishin në tavolinë me të.

Në deklaraminën e tij, Redi thotë se në këtë moment Ervis Martinaj po thoshte "mos, mos, mos", ndërsa Ervin Mata po thoshte "ç'a po boni, ç'a është kjo punë" dhe në këtë moment ka parë personin me bluzë me kapuç, i cili kishte një armë zjarri. Redi ka dëgjuar një krismë që ka ardhur nga vendi ku ndodhej personi i gjatë me kapuç në kokë që po konfliktohej me Jolin, por për shkak të rrëmujës, ky shtetas deklaroi se nuk e ka parë kush qëllon dhe kur dëgjo krismën është hedhur menjëherë pas banakut për t'u mbrojtur. Ky shtetas deklaroi se krismat kanë vazhduar dhe kur kanë përfunduar, afër banakut ka shkuar Ervis Martinaj, i cili ishte plagosur në qafë dhe Redi e ka marrë dhe e zbritur poshtë shkallëve drejt vendit të taksive. Kur doli nga banaku, Redi thotë se të gjithë personat ishin larguar përveç personit që kishte ngelur i vrarë dhe një person tjetër afër derës, që ishte duke u përpëlitur. Pasi nxori Ervis Martinajn jashtë, është ulur në trotuar për t'u kthjelluar duke pasur edhe një shishe në dorë dhe në këtë moment ka parë dy motorë policie ku ua ka bërë me dorë, duke i njoftuar se çfarë kishte ndodhur dhe më pas së bashku me ta është futur sërish në dyqan.

Ky shtetas në deklaraminën e tij deklaroi se një nga personat që shoqëronin Ervis Martinajn ishte rreth 170 cm i gjatë, rreth 30 vjeç, trup i dobët dhe i veshur me të

zeza, i njëjti person që ndodhej i plagosur tek dera e dyqanit, ndërsa personi tjetër ishte rreth 30 vjeç me rroba të çelura. Për shtetasin Ervin Mata, Redi deklaroi se kishte veshur një bluzë të zeze, xhinse të zeza. Joli, oficeri i Zallherit, mbante të veshur një xhup të zi, bluzë "Polo" ngjyrë blu të errët dhe xhinse të errëta, ndërsa në lidhje me dy personat që erdhën në momentin e fundit deklaroi se njëri prej tyre ishte rreth 30 vjeç me bluzë me kapuç dhe në momentin që u fut në dyqan, u konfliktua me Jolin, duke u sharë dhe goditur me grushte dhe më pas ky person kishte në dorë një armë zjarri. Personin tjetër që e shoqëronte nuk e kishte fiksuar. Gjithashtu, Redi Popesku shton se i plagosuri dhe i vrari ishin njerëzit e Ervis Martinajt dhe konflikti ka nisur për arsye banale, në lidhje me ngacmimin e të dashurës së shtetasit Ervin Mata, shtetasin Elvana Gjata dhe Ervin Martinajn janë takuar qetësisht në lokal, pa ndonjë tendencë për t'u agruar situata dhe kur ka ardhur në dyqan Ervis Martinaj, ka zbritur nga një automjet tip "BMW" me ngjyrë të

ERRËT. DESHMIA E DYTE E POPESKUT

I është marrë deklaraminë përsëri shtetasit Redi Popesku, ku ndër të tjera ka deklaruar se ditën e ngjarjes, rreth orës 20:40, përpara dyqanit të tij në ish-Bllok, ka ardhur shtetasja Elvana Gjata me automjetin e saj dhe aty në rrugë, duke qëndruar në parkim për dy, ka takuar shtetasin Ervin Mata dhe kanë shkëmbyer një çelës shtëpie. Në këtë moment, në rresht për tre ka kaluar një automjet tjetër dhe personat që kanë qenë brenda në automjet kanë ngacmuar Elvana Gjatën, por duke qenë Ervini prezent kanë debatuar me fjalë në të dhe në këtë çast nga dyqani i Redit kanë dalë Joli (Mevjoli Bilo), me djemtë e tjerë për t'u sqaruar. Sipas deklaraminës, ai nuk i ka fiksuar karakteristikat e makinës që kishte ngacmuar Elvana Gjatën, por edhe detajet e mësipërme i kishte dëgjuar nga Ervini, ku ky i fundit u tregonte personave që ishin të shoqëruar me të. Po ashtu kishte dëgjuar nga Ervini se personi i cili drejtoonte automjetin me personat që kishin ngacmuar Elvanën, kishte qenë shok i ngushtë i Ervin Matës.

ARRATIA E AUTOREVE


Autorët e ngjarjes pas të shtënave kanë dalë me shpejtësi nga lokali. Në kamera duket që njëri prej tyre është larguar në këmbë në rrugicat e Bllokut, tjetri me makinë, ndërsa i treti nuk duket në pamjet e kamerave të sigurisë.

ARSYET E SHERRIT SIPAS REDI POPESKUT

"Konflikti ka nisur për arsye banale, në lidhje me ngacmimin e të dashurës së shtetasit Ervin Mata, shtetasin Elvana Gjata dhe Ervin Mata me Ervis Martinajn janë takuar qetësisht në lokal pa ndonjë tendencë për t'u agruar situata", ka deklaruar Redi Popesku.

DEKLARATA E POLICISE

Policia në vendngjarje gjeti 11 gëzhoja arme zjarri tip "Glock", 10 000 euro, aparate celularë dhe 3 automjete. Pak pas krimit, policia gjeti edhe një motor në zonën e Kopshtit Botanik, që dyshohet se ka lidhje me ngjarjen.



PALET E PERFISHIRA NE SHERR

► Të plagosur, nën arrest

1. Ervis Martinaj, 36 vjeç, banues në Tiranë.
2. Eljon Hate, 28 vjeç, banues në Shkodër.

► I vrarë

1. Fabian Gaxha, 28 vjeç.

► Në kërkim nga policia

1. Ervin Mata, 31 vjeç, banues në Tiranë.
2. Fabio Allushi, 42 vjeç, banues në Tiranë.
3. Mevjoli Bilo, 41 vjeç, banues në Tiranë.

REPUBLIKA E SHQIPRISE
Zyra përmbarrimore "Best 2010"

SHPALLJE ANKANDI

Më datë 01 Dhjetor 2018 nga ora.08.00-ora.16.00 tek kjo zyrë përmbarrimore do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandin e ll-të, për shitjen e apartamentit nr. 3/218+1-18, vol 35, fq.39, ZK.8350, sip. 103.90 m2 me çmim fillestar 57120 lek/m2.

Apartamenti ndodhet në Tiranë (prapa Prokurorisë Rrethit Tiranë).

Për sqarime të mëtejshme kontaktoni në tel: 052226000 ose cel: 0692075 644

QKUM hedh poshtë akuzat e Pampurit

Deputetja e PD-së: Janë vjedhur 450 milionë lekë për uniformat e urgjencës

Deputetja e Partisë Demokratike, Orjola Pampuri, ditën e djeshme në një dalje për mediat është shprehur se qytetarëve u janë grabitur 450 milionë lekë për uniformat e urgjencës. Deputetja demokrate tha se është e papranueshme që për shërbimin e urgjencës nuk ka autoambulanca mjaftueshëm dhe ministria e Shëndetësisë mburret me uniformat e shtrënjta të personelit. Ajo i bëri thirrje ministres së Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu, që të japë llogari për skandalin e uni-

formave 800 mijë lekëshe të urgjencës, të cilat sipas saj, fshehin një aferë korupsioni dhe gjenden e mjerueshme të shëndetësisë. "Tenderi për uniformat e punonjësve të urgjencës me vlerë rreth 450 milionë lekë përbën një rast revoltues sesi abuzohen paratë e taksapaguesve. Rasti i denoncuar nga një emision investigativ provoi me dokumente zyrtare se një uniformë për shërbimin e urgjencës kushton rreth 800 mijë lekë, ndërsa cilësia është

nga më të këqijat", - tha deputetja. **REAGIMI I QKUM**
Pas akuzave të bëra nga PD, ka ardhur dhe reagimi i Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore. Përmes një deklaratë, QKUM hedh poshtë akuzat me argumentin se Urgjenca Mjekësore është me standard të ri bazuar në ligj. Ndërsa për shpenzimet e bëra për uniformat, QKUM sqaron se e gjithë procedura është bërë publike e bazuar ligjin e prokurimit publik. "Unifor-

ma e re e personelit mjekësor është sipas standardeve të urgjencës mjekësore, bazuar në ligjin 147/2014, i cili ka përcaktuar standardin e uniformave të urgjencës, në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare. Procedura e blerjes së uniformave të personelit mjekësor të urgjencës është transparente. Përballë shpifjeve po rendisim disa fakte dhe shifra në lidhje me uniformat e personelit të urgjencës. Çmimi dhe specifikimet teknike janë



deklaruar publikisht. Fondi total është 38 milionë dhe jo 45 milionë lekë, siç thuhet në deklaratë dhe procedura është kryer nga organi qendror blerës, bazuar në legjislacionin në fuqi", - sqaron QKUM.

Autoriteti Rrugor Shqiptar: Projekti i Unazës së Madhe të Tiranës, publik dhe zyrtar

Protestë në "Astir" për prishjen e banesave, rreth 200 familje do të dalin në rrugë

Banorët: Nuk na gënjejnë dot me lëmoshë, duam dëmshpërblimin real

Voltiza Duro

Dhjetëra banorë në zonën e "Astirit", në kryeqytet kanë protestuar ditën e djeshme kundër prishjes së banesave dhe bizneseve buzë rrugës që preken nga projekti i Unazës së Re. Ata tregojnë të revoltuar për "Gazeta Shqiptare" se protesta e tyre do të vijojë deri në zgjidhjen e situatës dhe marrjen e një dëmshpërblimi real për vlerën e banesave të tyre. "Jemi rreth 200 familje në 'Astir' që prekemi nga projekti i Unazës së Re, pra brenda 10 ditësh ne do të dalim në rrugë, pasi ky është afati që na kanë vendosur. Protesta do të vijojë edhe nesër (sot) e do të bllokohet rrugën derisa të na japin dëmshpërblimin që na takon realisht. Me lëmoshë nuk na gënjejnë dot. Nëse jemi me të vërtetë një shtet demokratik, le të ndjekin praktika demokratike dhe të mos na nxjerrin në rrugë në këtë mënyrë", - shprehet për "GSH" një prej banorëve, shtëpia e të cilit preket nga projekti. Ndërkohë sipas banorëve të zonës, rreth 10 familje nga 200 të tilla i kanë banesat të legalizuara, çka do të thotë se 190 familje mund të mos marrin dëmshpërblim, por mund të përfitojnë vetëm një pagesë vjetore qiraje. "Këtu maksimumi vetëm 10 familje i kanë banesat me leje legalizimi. Pjesa tjetër i ka në proces legalizimi, e kështu si po vjen situata, nuk e dimë nëse do të na i legalizojnë, pasi nuk u intereson. Ne kërkojmë dëmshpërblim, të vijmë instancat përkatëse dhe të bëjmë vlerësimin real të banesës. Protesta do të vijojë deri sa të gjejmë të drejtën tonë. Kemi punuar një jetë për këtë shtëpi e nuk mund ta prishim si pa të keq, e aq më tepër të na lejnë një



Protesta e banorëve të 'Astirit'



200

FAMILJE TË PREKURA

"Jemi rreth 200 familje në 'Astir' që prekemi nga projekti i Unazës së Re, pra brenda 10 ditësh ne do të dalim në rrugë, pasi ky është afati që na kanë vendosur. Protesta do të vijojë edhe nesër (sot) e do të bllokohet rrugën derisa të na japin dëmshpërblimin që na takon realisht."

"PROTESTA DO TË VIJËJË"

"Protesta do të vijojë deri sa të gjejmë të drejtën tonë. Kemi punuar një jetë për këtë shtëpi e nuk mund ta prishim si pa të keq. Kemi gjithë këto vite që i paguajmë taksat shtetit, drita e ujë, mund të na lajmëronin më parë", - thotë një tjetër banorë.

ARRSH

"Projekti është zyrtar dhe publik. Me zhvillimin e garës, e cila gjithashtu ka qenë publike, janë përcaktuar firmat fituese që do të zbatojnë projektin. Në përputhje me përcaktimet ligjore e nënligjore po veprohet në territor nga organet përkatëse të përfshira në proces si koordinim mes ARRSH, IKMT, ALUIZNI-t, Bashkisë Tiranë", - thotë ARRSH.

PROJEKTI

Banorët bëjnë me dije për "Gazeta Shqiptare" më tej se projekti ka marrë një zgjerim shumë më të madh nga sa ishte planifikuar më parë, përkatësisht nga 7 metra është shtrirë në 35 metra. "Në

fillim, pra në 2017-ën, në bazë të informacioneve që kemi, projekti shtrihet në 7 metra thellësi. Ndërsa tani e kanë shtrirë në 35 metra e preken shumë më shumë familje se më parë. Më kanë thënë që dëmshpërblimi që

do të marr për shtëpinë është 10 milionë lekë të vjetra, por shtëpia ime nuk vlen kaq. Me 10 milionë as një gasonerë nuk blen dot e jo më shumë", - thotë një prej banorëve për "GSH" gjatë protestës. **REAGIMI I ARRSH-SË**
Por, Autoriteti Rrugor Shqiptar, në një reagim në faqen e saj zyrtare lidhur me situatën e krijuar thekson se projekti ka qenë zyrtar dhe publik. Sipas ARRSH, projekti i Unazës së Madhe të Tiranës, që parashikon rikualifikimin nga Pallati me Shigjeta deri te sheshi "Shqiponja" është në fazën e zbatimit, duke parashikuar edhe zgjidhjen e trafikut. "Referuar një proteste të zhvilluar gjatë ditës së djeshme në Unazën e Re, Autoriteti Rrugor Shqiptar sqaron sa vijon: Si media dhe

opinionin publik është në dijeni, tanimë është në fazën e zbatimit projekti i Unazës së Madhe të Tiranës, rikualifikimi nga Pallati me Shigjeta deri tek sheshi 'Shqiponja', përfshirë edhe zgjidhjen e kësaj nyje të trafikut. Projekti është zyrtar dhe publik. Me zhvillimin e garës, e cila gjithashtu ka qenë publike, janë përcaktuar firmat fituese që do të zbatojnë projektin. Në përputhje me përcaktimet ligjore e nënligjore po veprohet në territor nga organet përkatëse të përfshira në proces si koordinim mes ARRSH, IKMT, ALUIZNI-t, Bashkisë Tiranë. Ditën e hënë do të komunikim me median për detaje të mëtejshme të projektit", - thotë ARRSH në faqen e saj zyrtare.

Bularat/ Meshë në kishë për 35-vjeçarin që qëllloi mbi policinë dhe u vra më pas nga RENE A

Ceremoni për Kaçifan, nëna: Ishte hero

Historiani Arben Llalla: Kanë zbarkuar forcat speciale greke

SI KA NDODHUR

Në prag të zhvillimit të festës së Greqisë, e cila si çdo vit u organizua edhe në qendër të fshatit Bularat në Gjirokastrë, të shtëna me armë tronditën zonën. Policia, e cila ishte stacionuar në qendër të fshatit për mbarëvajtjen e festës, menjëherë është nisur në drejtimin nga janë dëgjuar të shtënat, ndërsa identifikoi edhe personin që qëllloi me armë.



Nëna e minoritarit grek të vvarë, Kostandinos Kaçifas

ARBEN LLALLA

Përmes një postimi në "Facebook", historiani Arben Llalla thotë se gjatë meshës së mbajtur dje në Bularat të Gjirokastrës janë parë njerëz të ardhur nga Greqia me veshje të forcave speciale të ushtrisë greke. "Sot në kishën e Bularatit janë parë njerëz të ardhur nga Greqia me veshje të forcave speciale të ushtrisë greke. Njeriu me bluzë të zeze është njeri nga forcat greke...", - thotë Arben Llalla.

Këtë të diel në kishën e Bularatit u zhvillua një meshë për 35-vjeçarin Kostandinos Kaçifas, që u vra një javë më parë nga RENE A. E pranishme ishte edhe nëna e tij, Vasilja Kaçifa, e cila kërkoi kthimin e trupit të djalit dhe mbrojtjen e të drejtave të minoritetit. Nëna e 35-vjeçarit tha se ai do të mbetet hero, pasi e donte Vorio Epirin. "Të dalë i pafajshëm fëmija im. Konstandini do të mbetet hero dhe do të bëhem nënë e fortë, do ta bëj zemrën gurë për trimin tim. Na mbronni të drejtat tona. Djali e donte fshatin e tij dhe Vorio Epirin", - tha nëna e 35-vjeçarit. Edhe prifti i ka bërë thirrje ambasadores greke në Tiranë që të ndërhyjë tek autoritetet për të rikthyer trupin e Kaçifas në Gjirokastrë për ta varrosur.

REAGIMET

Përmes një postimi në "Facebook", historiani Arben Llalla thotë se gjatë meshës së mbajtur dje në Bularat të Gjirokastrës janë parë njerëz të ardhur nga Greqia me veshje të forcave speciale të ushtrisë greke.

"Sot në kishën e Bularatit janë parë njerëz të ardhur nga Greqia me veshje të forcave speciale të ushtrisë greke. Njeriu me bluzë të zeze është njeri nga forcat greke...", - thotë Arben Llalla. Mesha në Kishën e Bularatit është zhvilluar një javë nga vrasja e ekstremistit grek, Kostandinos Kaçifa nga RENE A. Në meshë merrnin pjesë të afërm dhe nëna e 35-vjeçarit të ndjerë.

NGJARJA

Në prag të zhvillimit të festës së Greqisë, e cila si çdo vit u organizua edhe në qendër të fshatit Bularat

Nëse do që fëmija yt të mos qëndrojë gjithë kohën para kompjuterit, apo telefonit mund ta orientosh drejt librit. Tanimë kanë nisur të aktivizohen bibliotekat e lagjeve. Më e fundit që është rikonstruktuar është biblioteka që ndodhet në njësinë numër 8 në Tiranë.

"Ka qenë prej kohësh një nga ambicjet tona që të kishim një strehë të tillë për librin në njësinë 8. Në fakt, kur hyn dhe shikon fotot se si kanë dalë bibliotekat e reja, u ngjajnë shumë kafeve luksoze. Ndjej një entuziazëm shumë të madh kur mendoj se kemi ardhur te dita kur shteti, publiku, bashkia, qyteti ofron të njëjtin luks për librin, siç e ofron kapitalisti për atë që shkon pi kafe në një nga 10 mijë kafet e Tiranës", u shpreh Veliaj. Të rinjtë tanimë duket se kanë sfiduar mitin e vjetër se shokët do t'i paragjykojnë

e t'i quajnë peshkop që shkon në bibliotekë, pasi ato po frekuentohen gjithnjë e më shumë. "Fakti që sot dikush që lexon nuk konsiderohet më një specie në zhdukje, i cili duhet të futet në një skutë të errët, me lagështi, por po i rezervojmë librit në kuptimin e mirë të fjalës, vanitetin që shoqëria jonë sot e kuzo-kapitalistit ua rezervon industrisë të tjera. Them se është një fitore e kulturës mbi antikulturën. Sot më vjen mirë, sepse kemi bërë një fitore të vogël, një hapësirë dikur komplet të degraduar e kemi shndërruar në një nga bibliotekat më të bukura e më të mira në zemër të Tiranës", shtoi Veliaj. Biblioteka e njësisë numër 8 mban emrin "Hamit Beqaj" dhe kryetari i bashkisë u bën thirrje të gjithëve të dhurojnë libra për bibliotekat e lagjeve për t'i pasuruar sa më shumë ato, por nga ana tjetër u kërkoi frekuentuesve t'i mirëmbajnë dhe mos t'i shkatërronjë ato.



ERION VELIAJ

"Ka qenë prej kohësh një nga ambicjet tona që të kishim një strehë të tillë për librin në njësinë 8. Në fakt, kur hyn dhe shikon fotot se si kanë dalë bibliotekat e reja, u ngjajnë shumë kafeve luksoze. Ndjej një entuziazëm shumë të madh kur mendoj se kemi ardhur te dita kur shteti, publiku, bashkia, qyteti ofron të njëjtin luks për librin, siç e ofron kapitalisti për atë që shkon pi kafe në një nga 10 mijë kafet e Tiranës", u shpreh Veliaj.

Projekti i suksesshëm, rikonstruktohet ambienti tek njësi 8

Bibliotekat e lagjeve, Erion Veliaj: Investimi në to, fitore mbi antikulturën

at në Gjirokastrë, të shtëna me armë tronditën zonën. Policia, e cila ishte stacionuar në qendër të fshatit për mbarëvajtjen e festës, menjëherë është nisur në drejtimin nga janë dëgjuar të shtënat, ndërsa identifikoi edhe personin që qëllloi me armë. Kostandinos Kaçifa sapo ka parë shërbimet e policisë që po afroreshin në drejtim të tij, ka hapur zjarr në breshëri ndaj punonjësve të policisë, duke rrezikuar jetën e tyre. Fatmirësisht nga të shtënat nuk ka punonjës policie të plagosur, por vetëm është thyer xhami i mjetit të policisë. Policia menjëherë ka rrethuar zonën, ku përsëri ky shtetas ka hapur zjarr në drejtim të punonjësve të policisë që po e ndiqnin. Shtetasi Kostandinos Kaçifa u fut në thellësi të fshatit ku forcat "Shqiponja" dhe shërbimet e tjera të Drejtorisë Vendore të Policisë vijuan krehjen e zonës për të bërë të mundur kapjen e tij. Në ndihmë të shërbimeve të Policisë së Gjirokastrës shkoi edhe një helikopter i Ministrisë së Brendshme dhe forcave speciale RENE A nga Tirana, që bënë të mundur edhe lokalizimin e autorit. Por, pasi nuk i përgjigj thirrjes së policisë për t'u dorëzuar, 35-vjeçari qëllonte me armë zjarri, ndërkohe që mbeti i vvarë.

Shitje me Ankand të dyte nga Studio Perbarimore L.D.C
Shitje me Ankand të dyte nga Studio Perbarimore L.D.C
-Apartamentin me nr. 2/260+2-6, vol 30, faqe 140, sip. 104.12 m2, ZK 8330, regjistruar ne Z.V.R.P.P. Tirane .Çmimi fillestar per shitje eshte 4.700.000 Lekë.
Data e shpalljes 11.09.2018
Data e zhvillimit 11.10.2018 deri ne oren 16.00
Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Perbarimore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

Shoqëria perbarimore JUSTITIA
Shoqëria perbarimore JUSTITIA shpall ankandin, faza dyte, për shitjen e pasurisë së paluajtshme me këto të dhëna:
Apartament me nr.pas.7/21+1-4 , zk.8360, vol.26, lq. 204, me sip.138.40 m2, Tiranë në pronësi të Gentian Kujtim TOSKU
Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 81.379 (tetëdhjetë e një mijë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë) EUR.
Ankandi zhvillohet në datën 04.12.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbaruesit gjyqësor, me adrese Bulevardi"Baïram Curri", Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON" ME PËRMBARUESE GJYQËSORE SUELA METHOXHA
Dt. 05.11.2018 ora 16:00
Përfundon Ankand i Dytë për pasuritë:
- Pasuria "Lokal nr.4" me sip.66 m2, me adresë L.13, Plazh Durrës
Me çmim 46 200 Euro
- Pasuria "Lokal nr.5" me sip.43 m2, me adresë L.13, Plazh Durrës
Me çmim 36 120 Euro
- Pasuria "Lokal nr.6" me sip.110 m2, me adresë L.13, Plazh Durrës
Me çmim 98 560 Euro
Ankandi Zhvillohet në zyrën e STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON", me

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



INTERVISTA

MIMOZA HAFIZI:

Për jetën përtej tokës, në një roman mes shkencës e rrëfimit

Fatmira Nikolli

Si është një shkencëtare kur del nga qendra kërkimore, pasi ka kaluar ditën me planetët dhe ecën nëpër rrugët e një qyteti dhe ulët para kompjuterit? Mimoza Hafizi sjell romanin "Pika Trëndafil", emri i të cilit është stilizuar nga planeti i zbuluar dy vjet më parë, që sillt rrotull yllit më të afërt me Diellin, yllit Proxima. Vepra letrare që sjell botën shkencore në një mënyrë të thjeshtë, rrjedh përmes ngjarshes reale apo imagjinare, nëpërmjet komunikimesh e refleksioneve që zhvillohen në qendrat më të rëndësishme botërore të kërkimit të hapësirës. Personazhet e tij kanë emra, temperamente dhe karaktere shkencëtarësh, që Mimoza Hafizi i ka ndeshur në jetën dhe bashkëpunimin e saj të gjatë shkencor. Përmes të vërtetave shkencore zbulohen gradualisht dhe me terma të zbutur, personazheve të imagjinuara, por tipike në mjedisin e vet, përmes ngjarshes të lidhura me fëmijërinë, qytetin e saj të lindjes, episodet të përjetuara në vëprimtarinë e saj shkencore, përsiatjet filozofike e fantazish në kufijtë e dijes rreth botëve të reja, pa natë a pa kohë. Autorja tenton t'u japë lexuesve dijet e deritanismet rreth planetëve të zbuluar jashtë Sistemit tonë Diellor. Aty ku mundet apo nuk mundet të ketë jetë dhe qenie të arsyeshme, të ngjashme me njeriun tokësor.

Si janë planetët e tjerë, që sillen qark yjeve të tjera? Si mundemi t'i njohim ne ato botë të errëta e të vogla, me dhjetëra e qindra vite-dritë larg nesh? Sa të sofistikuara dhe inteligjente janë metodat tona? Çfarë progresi të vullshëm bartin dhe sjellin instrumentet e teleskopit e vrojtimit? Çfarë karakteresh dhe temperamentesh kanë kërkuesit shkencorë? Cili është motivi i tyre? Përse është kaq e rëndësishme për njeriun ta njohë botën e sipërme? Sa e pasur është ajo? A ka alienë? A i presim? Çfarë do të ndodhë në dekadat e ardhshme?

Këto janë shumë pyetje, që tokësorët meritojnë ta dinë përgjigjen, pa u stërmunduar në formula e llogaritje profesionale. Përgjigjet e thjeshta e të këndshme, dhënë në faqet e romanit, mëtojnë të nxjerrin nga subkoshienca e secilit atë që natyra e ka shkruar pakthyeshmërisht në gjenet tona: kërkimin për të vërtetën, betejën e njerëz-



Mimoza Hafizi gjatë promovimit të librit "Pika Trëndafil"

imit për mbijetesë dhe ekspansionin e llojit të vet. Në roman janë përfshirë tri piktura origjinale, dhuruar bujarisht nga piktorët Pashk Përvathi (kopertina) dhe Nineta Verbica (dy faqet e brendshme). Ato shprehin artistikisht idenë shkencore që autorja ka për tre planetë tipikë jashtëdiellorë. Në intervistën e mëposhtme Mimoza Hafizi zbulon veten dhe romanin dhe përmes tij, një jetë që ne nuk e njohim. Hafizi, më herët shkencëtare e deputete, tanimë vjen në një tjetër imazh para publikut, për të përcjellë jetën e saj të panjohur për ne.

Ju thonë se nuk flisni për një publik elitare, që është i familjarizuar me shkencën në roman, por me një gjuhë që i drejtohet një publiku më të gjerë. Çfarë ju shtyu ta shkruanit, nevoja për të treguar punën shkencore të një rreth më i gjerë?

Shtyja ime për këtë roman shkencor ka qenë dëshira për të komunikuar me njerëzit që nuk janë profesionistë, për arritjen e jashtëzakonshme të njerëzimit me njohjen e universit dhe në veçanti me njohjen planetëve jashtë sistemit diellor, aty ku mund të ketë jetë e ku mund të ketë qenie të tjera të arsyeshme përmes nesh. Sigurisht këtë emocion unë e komunikoj gjithnjë me studentët e mi përmes formulave, por kësaj herë unë desha të gjej një mënyrë më të thjeshtë, që çdokush me formim, që përfshin shkencën të kuptojë se çfarë po ndodh, se si

Shkencëtarja boton "Pika Trëndafil", një planet i ri e jeta në qendra kërkimore shkencore botërore

njerëzimi i mijëvjeçarit të tretë ka arritur të depërtojë kaq thellë deri në mijëra e miliarda vite dritë larg dhe të kërkojë jetën edhe në planetë të tjerë të galaksisë sonë.

-Pra, ne nuk jemi vetëm në këtë planet dhe a duhet të kemi frikë nga alienët?

Shkenca është mjaft e avancuar për të thënë që nuk ka asnjë rrezik të afërt që i vjen tokës, në planetët rreth e rrotull, por edhe alienë të tjerë, ende nuk kemi gjetur, jemi ende në një përpjekje për të kuptuar se ku mund të ketë jetë. Nga mijëra planetë që kanë zbuluar teleskopët

tonë, janë rreth 30 të cilët ndodhen në zonën e banueshme, zonë në të cilën mund të ketë jetë, e me njohjen që kemi sot po kërkohet të detajohen këto dije për të parë nëse me të vërtetë ka jetë nëpër këta planetë. Ky është një sukses i jashtëzakonshëm i njerëzimit të mijëvjeçarit të tretë, sepse planeti i parë është zbuluar jo më shumë se 20 e ca vite më parë dhe sot kemi 4 mijë të tillë, dhe lista pritet të shtohet në vitet ardhshme.

-Mënyra e të rrëfyerit është krejt letrare në roman, ndonëse rrëfohen qendra kërkimore të mëdha të botës. Ka qenë i vështirë ky proces?

Kam përzgjedhur personazhe që punojnë në qendrat kërkimore të tokës sot, në qendrat më të avancuara. Janë njerëz që unë i njoh, në karaktere dhe në temperament dhe besoj se jeta e tyre është kaq e thjeshtë, kaq e zakonshme e kaq e bukur sa që vetë përskrimi i jetës dhe ajo që mendojnë është mjaft interesante për njerëzit besoj. Ndaj nuk e kam pasur të vështirë, më ka ndihmuar njohja që kam për ta, bukuria e jetës së shkencëtarit në të cilën besoj dhe emocionin pa fund që më japin zbulimet që janë ditë pas dite që gjej në instrumentet tona hapësinore e tokësore, të cilat tregojnë për një aftësi kaq

të madhe të inteligjencës njerëzore për të depërtuar thellë në univers sa kjo nuk ka se si të emocionojë. E ky emocion, mjafton jo vetëm për një roman, por edhe për të shkruar shumë romane.

-Për të rrëfimit dhe asaj që ne vetë përftojmë prej tij, a kemi pasur ju vetë një mesazh që do të donit ta përcillnit për lexuesit?

Mesazhi im kryesor është që shkenca është e bukur. Besoj se këtë e kam ndjerë sepse doja ta tregoja. Shkenca nuk është e vështirë, ose jo aq e vështirë sa e mendojnë njerëzit e papërfshirë në të. Shkenca është e bukur dhe bota shkencore është mjaft mikpritëse për këdo që do të bëhet pjesë e saj.

-A jeni vetë ju dhe kolegët tuaj, në roman si personazhe?

Besoj se njerëzit përdërisa kam vënë në gojë e tyre mendimet e mia, ata njerëz, ata personazhe në një farë forme janë unë dhe kolegët e mi, që unë i njoh. Janë njerëz që unë i kam takuar gjatë jetës sime shkencore. Nuk i kam vendosur në pozicionet që ata kanë, jo në kontekstin e njohjes që kam pasur unë. Një njeri që punon në njohjen e planetëve të sistemit diellor unë e kam vënë në universin e njohjes së energjive të larta, por kjo nuk ka rëndësi, sepse tipikisht mbeten ai personazh që unë i njoh si punojnë, çfarë metodike kanë, çfarë për të zbuluar, çfarë formatimi e formimi kanë dhe thjesht jam munduar që ta kaloj nëpër faqet e romanit.

-Pse "Pika Trëndafil", cila është domethënia?

Kur u fotografua toka nga sonda "Voyager" më 1990 dukej si pikë e kaltër. Toka ngjante si një pikë e vogël e kaltër dhe e brishtë, e ishte kaq emocionuese, kur mendoje se e gjithë ajo histori pa fund që është prodhuar në tokë nëpër shekuj, nga larg e nga lart, ngjante veçse një pikë e vogël e kaltër. Ajo quhej Pika e Kaltër. Të emocionuar nga ky imazh, shkencëtarët që zbuluan këtë planetin afër nesh, që unë e kam quajtur Pika Trëndafil, fushatën e quajtjen Pika e Kuqe e Zbëhtë, sepse ylli rreth të cilit sillt ai planet është i kuq, jo si dielli ynë që ka ngjyrë portokalli, meqë ai është më i vogël dhe më i ftohtë. Ndaj mora fjalën Pika e Kuqe, që mund të ishte edhe Pika e Kuqe dhe e vura Pika Trëndafil, sepse trëndafil është lulja e Shkodrës dhe kjo mund të jetë, sepse njeriu kur shkruan, nxjerr shumë nga vetja. Trëndafil është lule e bukur, është lule e jetës dhe kjo shpreh edhe dëshirën time, që në atë planet të ketë jetë.



Opinion i Ditës

Rendi i prioriteteve diplomatike dhe strategjike të Kosovës

Nga Halil Rama

Gjashtëdhjetë e katër artikuj, analiza të mirëfillta diploma tike të kalvarit që përtejoi dhe po përjeton Kosova, nga prag Rambujeja e fillimvitit 1999, të pavarësi mi e ecejaket për të formuar shtetin e ri, e deri te dritëhijet e projektit makabër të korrigjimit apo ristrukturimit të kufijve, apo shkëmbimit të territoreve përbëjnë lëndën e librit të ri të diplomatit të mirënjohur Shaban Murati, "Kalvari diplomatik i shtetit të Kosovës". Në këtë libër që u prezantua para disa ditësh për qindra diplomatë, analistë e gazetarë nga Shqipëria, Kosova, rajoni e bota gjejmë analiza të mirargumentuara të ngjarjeve e zhvillimeve në harkun kohor të dy dekadave të fundit. Ato hedhin dritë mbi politikën dhe diplomacinë e kulisave dhe për provokimet e synimet e mbrapshta të qarqeve shoviniste serbe, të segmenteve e individëve për të penguar shpalljen e pavarësisë dhe formimin e konsolidimin e shtetit të ri të Kosovës.

Diplomati i karrierës, eksperti i Kosovës, Ballkanit dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, Shaban Murati sjell kështu për publikun e gjerë një antologji të analizave sistematike për problematikën diplomatike të shtetit të Kosovës, që nga krijimi i tij, deri në ditët e sotme. Kontributi i diplomatit të mirënjohur konsiston kështu para së gjithash në dhënien e përgjigjeve për pikëpyetjet dhe për zhvillimet e sotme rreth Kosovës. Dhe këtë e bën nëpërmjet sistematizimit të çështjeve, konsekuencës dhe dinamikës e ndjekjes së tyre në zhvillim e sipër, çka e bëjnë librin aktual dhe të mirëpritur nga lexuesi.

Si askush tjetër, diplomati Murati ka kurajën që t'i kundërvihet edhe qëndrimit të hershëm të Akademisë së Shkencave për një të ashtuquajtur "platformë për zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare", që sipas tij nuk ishte as shkencore dhe as patriotike (24.11.1998). Ndër argumentet bindëse që sjell autori është qëndrimi i atëhershëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për të rikthyer mbrapsht historinë e Kosovës, duke e detyruar popullin shqiptar të pranojë statusin, që i dha atij Beogradit në 1974. Është vërtetë absurd ky qëndrim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë që konsistonte në minimizimin e kërkesave të kosovarëve vetëm tek "elementi konstitui".

Por, duke ndjekur kronologjinë e ngjarjeve, autori natyrshëm rendit mesazhin historik të SHBA për Kosovën në prag të Rambujesë. Në këtë këndvështrim, ai sjell në vëmendjen e opinionit publik deklaratën e ish-Sekretares amerikane të Shtetit, Medlin Ollbrajt në Uashington, vetëm një ditë para Konferencës Ndërkombëtare për Kosovën që u mbajt me nismën e Grupit të Kontaktit më 6 shkurt 1999 në Rambuje të Francës. Në mbështetje të dëshirës së shqiptarëve të Kosovës për pavarësi, shefja e diplomacisë amerikane deklaroi se, "ne nuk u kërkojmë atyre njerëzve të heqin dorë nga ëndrrat e tyre".

Pikërisht, duke u mbështetur tek ky qëndrim konstant i diplomacisë amerikane, si dhe në Rezolutën 1244



të KS të OKB për Kosovën, diplomati shqiptar Sh. Murati konkludon se "Statusi aktual që gëzon Kosova, pikërisht në kuadër të rezolutës së mësipërme, mbi bazën e së cilës ajo ka të sanksionuar kujdestarinë ndërkombëtare, e mbështet dhe i jep plotfuqishmëri legale të drejtës, që ajo të kërkojë pjesën e saj të pasurisë që i takon dhe që të jetë e pranishme në tryezat e ndarjes së pasurive midis njësive federale të ish-RSJS". (17.12.2000). Mjafton të konsiderojmë kohën kur është bërë, për t'u bindur në vërtetësinë e analizës së mirëfilltë diplomatike të ambasadorit Murati, i cili që para 18 vitesh ishte i qartë për kalvarin që do të kalonin bisedimet midis Prishtinës e Beogradit, qoftë edhe në këndvështrimin e ndarjes së pasurive. Po në këtë këndvështrim e ka parë autori të drejtën që kishte dhe ka Kosova të kërkojë reparacionet (Libri "Serbia kundër

Serbisë. Analizë e një gjysmërevolucionit të lënë përgjysëm", fq.77-81).

Në librin e ri "Kalvari diplomatik i shtetit të Kosovës", një vend të rëndësishëm zë qëndrimi i autorit ndaj serbizimit të diplomacisë të disa shteteve (si Spanja) për t'u shkëputur nga gjithë shtetet e G-7 dhe nga shtetet e mëdha të NATO-s, të cilat kanë njohur shtetin e Kosovës (16.06.2008). Duke ndjekur këtë linjë, jo më kot autori evidenton dhe habinë e madhe që përfshiu qarqet diplomatike dhe mediatike ndërkombëtare nga inati "sui generis" i Serbisë me dy shtetet fqinjë, Malin e Zi dhe Maqedoninë, me rastin e njohjes së Kosovës nga ana e tyre, qëndrim intaor ky që Beogradi nuk e ka mbajtur ndaj 115 shteteve tjera që kanë njohur shtetin e Kosovës.

Në koherencë me qëndrimet e sotme kur nga qarqet të caktuara proserbe është hedhur në treg ideja e mbrapshtë e ndryshimit të kufijve dhe e shkëmbimit të territoreve, ambasadori, publicisti dhe diplomati, profesor dhe "Mjeshër i Madh në Diplomaci", Shaban Murati, konkludon se "rendi i prioriteteve diplomatike dhe strategjike të Kosovës është i thjeshtë: Njohja e shtetit të Kosovës nga Serbia. Ky është prioriteti i prioriteteve!". (13.08.2018).

Duke përveçuar çështjet më të mprehta, me të cilat është përballur diplomacia dhe shteti i Kosovës në dhjetëvjetëshin e parë të jetës së tij, analiza e autorit përqendrohet në frontin e vështirë diplomatik të përballimit me diplomacinë e Serbisë

në rajon dhe në arenën ndërkombëtare, si dhe në përkosovare të diplomacisë ruse. Po ashtu, në këtë libër zënë vend të veçantë analiza të mirëfillta diplomatike pas ballafaqimeve me segmente të diplomacisë europiane, e cila jo gjithmonë ka ruajtur koherencën e saj për Kosovën dhe për Ballkanin. Libri "Kalvari diplomatik i shtetit të Kosovës" trajton gjithashtu edhe disa marrëdhënie dhe probleme diplomatike midis Shqipërisë dhe Kosovës. Por gjithsesi, nga diplomati i mirënjohur Sh. Murati, një trajtim të thelluar marrin temat e mekanizimeve dhe intrigave diplomatike të Serbisë dhe aleatëve të saj kundër pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit të Kosovës.

Duke vijuar me titujt e analizave të tjera që përfshihen në këtë libër, është fare e lehtë të arrish në përfundimin se sa i vëmendshëm ka qenë ambasadori Murati në ndjekjen e zhvillimeve të përditshme, të përjavshme e të përmuajshme të këtyre 20 viteve të fundit në shtetin e ri të Kosovës.

Për këtë, vëmendje edhe për analizat e spikatura të ambasadorit Murati pas çdo qëndrimi regresist të diplomacisë serbe e të qarqeve të caktuara ndërkombëtare që kanë synuar dhe synojnë të minojnë progresin e shtetit të ri të Kosovës, janë shprehur figura të shquara nga fusha politike dhe akademike si zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj; ambasadori Maxhun Peka, kryetari i Fondacionit "Alsar" Mehdi Gurra; analisti Aleksandër Cipa dhe profesor Ylber Sela. E përbashkëta në vlerësimet e tyre është vështirimi me anë të një pene mjaft diplomatike i ambasadorit Murati në këtë kalvar diplomatik, që ka kaluar dhe po kalon Kosova.

Si njohësi më i mirë i Kosovës dhe raporteve të saj me rajonin, Shaban Murati sjell në këtë libër të një rëndësie të veçantë, jo një temë, por disa tema të veçanta, të cilat i trajton më nënryrën më të mirë të mundshme.

Artistë! Arti jua bën jetën të bukur.

sigurohuni që ta shijoni atë gjatë dhe shëndetplotë!



Të gjitha përfitimet në një zgjidhje, me sigurimin Jetë dhe Shëndet Cash Plan! Siguroni veten dhe familjen tuaj, duke filluar nga 85 euro në vit/person dhe përfitoni mbulim për ndërhyrje kirurgjikale, vizita, analiza, medikamente, etj. deri në 25,000 Euro/vit.

- Sigurim Jete
- Checkup mjekësor vjetor
- Mbulim të shpenzimeve shëndetësore
- Zbritje deri në 60% në spitalet dhe klinikat private pjesë të rrjetit mjekësor SiCRED

SIGURIMI JETË dhe SHËNDET CASH PLAN



Për të blerë policën, kontaktimi me SiCRED në: Tel: +355 4 22 37 549 | Cel: +355 69 20 84 026 | e-mail: shitje@sicred.com.al



MJEKU POPULLOR




Ylli Merja:
Si të trajtoni me bimë
mjekësore problemet e
gjëndrës tiroide

KESHILLA



Si të parandaloni
gripin nëpërmjet
vaksinimit

VLERA LEKAJ:



◆
Mjekja
patologe:
Antikoagu-
lantët dhe
funksioni i
tyre në
shpëtimin e
jetës

Si të parandaloni sulmet në zemër dhe infarkt

"Njihuni me medikamentet
që duhet të përdorni"

Njihuni me 3 ushqimet që ndihmojnë në pastrimin e mushkërive



Voltiza Duro

Mjekja patologe: Antikoagulantët dhe funksioni i tyre në shpëtimin e jetës

Vlera Lekaj:

Si të parandaloni sulmet në zemër dhe infarktin

"Njihuni me medikamentet që duhet të përdorni"

Jo pak persona në ditët e sotme shfaqin shqetësime me rrahjet e zemrës, çka rrit mundësinë për formim trombesh e si pasojë edhe për të kaluar infarkt. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjekja patologe, Vlera Lekaj tregon disa prej trajtimeve që duhet të përdorin pacientët që kanë çrregullime të tilla, me qëllim shpëtimin e jetës. Më tej mjekja thekson se në mënyrë absolute nuk mund të ndërpritet medikamenti pa sugjerimin apo këshillën e mjekut. Gjithashtu, Lekaj shton se Warfarina është një tjetër antikoagulant i rëndësishëm në praktikën klinike për të mbrojtur nga formimi i trombeve. Ky medikament inhibon veprimin e enzimave që përdorin vitaminën K për prodhimin e faktorëve të koagulimit, duke ndërhyrë kështu në procesin e koagulimit dhe si pasojë duke e zgjatuar atë.

Çfarë janë antikoagulantët? Antikoagulantët përfaqësojnë një klasë të rëndësishme medikamentozë, e cila shërben për një mision thelbësor në ndalimin e formimit të trombeve në qarkullimin e gjakut. Një nga emrat më të rinj në treg dhe më të lakuar është dhe Rivaroxaban, i njohur ndryshe si Xarelto. Rivaroxaban përfshihet në atë grup antikoagulantësh të quajtur inhibitorë të faktorit Xa të koagulimit. Nëpërmjet inhibimit të këtij faktori të rëndësishëm në procesin e koagulimit të gjakut, ky lloj antikoagulantit ul drejtpërdrejt në këtë mënyrë afërsisht në koaguleuse të gjakut.

Ku përdoret ky lloj medikamenti?

Përdorimi i tij është kryesisht i përqendruar për rastet e trajtimit të trombozave venoze si dhe embolive pulmonare, si dhe ka një funksion të rëndësishëm parandalues të infarktit akut në pacientët, të cilët vuajnë nga fibrilacioni atrial. Te këta pacientë në të cilët si pasojë e rrahjeve të çrregullta të zemrës, rritet mundësia për formim trombesh dhe si pa-

sojë për të kaluar infarkt. **Sa është doza e përcaktuar e barrave për trajtimin e trombozave venoze?**

Doza ditore e këtij medikamenti varion në 2 herë në ditë për 21 ditë në rastet e trajtimit të trombozave venoze dhe embolive pulmonare dhe më pas kalon në një dozë të vetme ditore. Si dhe në rastet e parandalimit të infarkteve në pacientët me fibrilacion atrial përdoret një dozë e vetme ditore, me vaktin e darkës rekomandohet zakonisht. Marrja e Rivaroxaban duhet të jetë e rregullt dhe në të njëjtin orar të ditës, duke ndjekur këshillat e dhëna nga mjeku.

Kur është e këshillueshme ndërprerja e medikamentit?

Një vëmendje e veçantë u këshillohet pacientëve nga mjekët për mosndërprerjen në mënyrë absolute të këtij medikamenti pa sugjerimin apo këshillën e mjekut. Medikamenti duhet të vazhdohet edhe nëse ndjeheni mirë si dhe në rast ndërprerjeje të rivaroxaban për një arsye ose tjetër siç mund të jetë një efekt anësor i mundshëm i tij me epistaksis (hemorragji nga hunda) apo një vend tjetër hemorragjie, atëherë duhet të zëvendësohet me një antikoagulant tjetër. Te mjeku i familjes, diagnoza e fibrilacionit atrial është ndër më të shpeshtat dhe përfaqëson një nga sëmundjet kronike me incidencë të lartë në popullatë, ku më të prekurit janë moshë e mesme dhe të moshuar. Ndërsa marrja e rivar-



Mjekja patologe, Vlera Lekaj

oxaban është e indikuar vetëm në raste të rrezikshme. Sigurisht, tek pacientët të cilët krahas diagnozës bazë, kanë edhe sëmundje të tjera shoqëruese si insuficiencë kardiale, diabet mellitus, ishemi cerebrale është një kuadër alarmues, që kërkon ndërhyrjen me këtë

medikament të fuqishëm në parandalimin e formimit të trombeve. **Si mund të parandalohet formimi i trombeve?**

Përpara se të prezantoj një studim të kohëve të fundit që tregon epërsinë e xarelto në raport me antikoagulantët e tjerë, do të flas pak

për barin Warfarinë. Warfarina është një tjetër antikoagulant i rëndësishëm në praktikën klinike për të mbrojtur nga formimi i trombeve. Warfarina inhibon veprimin e enzimave që përdorin vitaminën K për prodhimin e faktorëve të koagulimit, duke ndërhyrë kështu në procesin e koagulimit dhe si pasojë duke e zgjatuar atë.

Çfarë u konstatua në studim?

Në studimin retrospektiv në popullatë reale krahasohet incidenca e hemorragjive gastro-intestinale në pacientët e trajtuar me antikoagulantë që nuk janë antagonist të vitaminës K dhe Warfarinës.

Ku në rastin e parë u regjistruan vetëm 5 pacientë me hemorragji madhore, ndërsa në rastin e dytë u regjistruan 158 raste. Si dhe gjatë hospitalizimit 90-ditor të pacientëve, 12 pacientë në grupin e Warfarinës vdiqën dhe 2 pësuan trombozë të venave të thella, ndërsa në grupin e antikoagulantëve jo antagonist të vitaminës K nuk pati asnjë rast vdekjeje, aksidente cerebro-vaskulare, apo tromboza te venave të thella. Studimi tregon ndjeshëm epërsinë e antikoagulantëve joantagonist të vitaminës K, ku Xarelto është një nga përfaqësuesit e këtij grupi. Sigurisht është një nga zhvillimet më të mëdha në mjekësi dhe në farmaceutikë dalja në treg e një medikamenti të tillë. Një medikament me efekte anësore të rralla, i cili parandalon rrezikun e infarktit të të sëmurët me fibrilacion arterial, duke shpëtuar qdo ditë një jetë.

Voltiza Duro

Gjendra e tiroides ka një rol të rëndësishëm në organizmin e njeriut, pasi është përgjegjëse në prodhimin e dy hormoneve që janë tiroksina dhe trijodotiroksina. Por jo në pak raste, sasia e jodit nuk qëndron brenda parameleve normale e kjo sjell probleme të shumta në shëndetin e njeriut. Femrat janë 4 herë më të predispozuar sesa meshkujt për t'u prekur nga sëmundjet që lidhen me gjendrën tiroide. Gjendra e tiroides ndodhet në pjesën e përparme të gushës, poshtë laringut dhe në përgjithësi peshë varion nga 15-22 gramë. Roli i saj në organizëm është tejet i rëndësishëm e kjo nis që në fillimin e embriionit; pra, nëse tiroidja është në normë edhe truri në fetus zhvillohet normalisht, e po ashtu edhe dhëmbët, flokët, organet. Kjo gjëder kaq e vogël ka si aktivitet primar prodhimin e dy hormoneve që janë tiroksina dhe trijodotiroksina. Tiroksina ka si funksion që gjatë prodhimin nga tiroidja një pjesë të shokjës të akumulohet në mëlcijë dhe pjesa tjetër të komandojë hipofizën, në mënyrë që kur bie niveli i TSH-ashit në gjak, të nxitet prodhimi i tij. Ndërsa trijodotiroksina komandon aktivitetin fiziologjik të organizmit, pra është një jod, i cili merr pjesë në prodhimin e enzimave dhe i stimulon ato për punë, kur është në parametra normale. Ka raste kur ky jod nuk është brenda normave normale e si pasojë fillon të "calojë" organizmi. Po përmend dy sëmundje patologjike të para që tregojnë se gjendra tiroide nuk funksionon normalisht. Mungesa e hormonit të tiroides është një nga shenjat e para, e cila njihet si hipotiroidizmi dhe shoqërohet me këputje trupore, dëshirë për të fjetur, tharje e lëkurës, rënie flokësh (nëse shihet në analizë, rrënja e qimes rezulton e rrudhosur, e këputur). Gjithashtu, hipotiroidizmi shoqërohet edhe me uljen e pulsit të zemrës dhe shenja nervozizmi që shfaqet pa shkak, shpesh, por që zgjat pak kohë. Në rastet kur individi ka këto



Mjeku popullor: Simptomat kryesore që nuk duhet t'i neglizhoni, moshat më të prekura

Ylli Merja:

Si të trajtoni me bimë mjekësore problemet e gjendrës tiroide

"Efektet e mrekullueshme të kurës me arra"

shenja klinike, zgjidhja më e mirë është që të bëjë një vizitë te mjeku, të realizojë një eko të tiroideve si dhe kryhet një analizë për të parë nivelin e jodit në gjak. Tiroidja përpunon jodin që e merr organizmi nëpërmjet ujit apo produkteve të ndryshme ushqimore. Në të dyja format e marrjes së jodit bëhet ky përpunim dhe enzimato fillojnë të stimulohen. Moshat më të prekura nga çrregullimet e gjendrës tiroide janë ato mbi 50-të vjeç ndërsa vlen të theksohet se femrat janë 4 herë më të rriskuara sesa meshkujt. Kjo, pasi ajo fillon që të futet në periudhën e menopauzës dhe ka një rënie të përgjithshme të gjendrave endokrine të saj siç është edhe gjendja e tiroides. Ndërsa në rastin e hipertiroidizmit, kur



Ylli Merja

ullimin e funksionit të gjendrës tiroide. Mund të përdoret një gjysmë kokërr në javë, pasi e keni lënë 30 ditë në mjalte, e kjo është më se e mjaftueshme për t'i siguruar organizmit sasinë e jodit të munguar. Ndërkohë edhe petat e arrës janë të pasura me jod e tanine dhe ndikojnë edhe në sistemin nervor, por edhe ndihmon në absorbimin e jodit nga trupi. Nëse konsumojmë 2 lugë çaj në ditë vaj kokosi, atëherë do të rregullohet mirëfunksionimi i tiroides, por do të frenojë rënien e flokëve. Edhe likopsi është i mrekullueshëm për të gjithë ata persona që kanë tepri të jodit në gjak pasi është e vetmja bimë që garanton largimin e jodit të tepërt nga organizmi, qetësimin e sistemit nervor si dhe balancon ngacimim dhe gjendrave për prodhimin e hormoneve të tiroides. Ndërkohë, gjembii gomarit rregullon e përmirëson funksionin e mëlcisë, çka ndikon në qetësimin e gjendrave me sekrecion të brendshëm. Por edhe çaji i gelbër e bajamet e egra kanë efekte të shpejta në përmirësimin e gjendjes shëndetësore të personave që vuajnë nga tiroidja.

këto tiroide janë më shumë të stimuluar do të dallohen të kundërtat e shenjave të para si: individi flet shpejt, është shumë aktiv, i papërmbajtur. Edhe në këto raste pacienti duhet të kryejë patjetër ekzaminimin e tiroideve. Në të vërtetë njerëzit nuk e mendojnë që ky çrregullim kaq i vogël, në miniaturë i tiroides sjell këto pasoja kaq të mëdha. Të sëmurët mund të kryejnë lloj-lloj analizash të tjera, por shkak i vërtetë qëndron diku tjetër.

KURIMI ME BIMË MEDICINALE

Në varësi nga stadi i sëmundjes,

përdorim bimë efikase, stimuluuese për të rikthyer funksionimin normal të saj. Nëse do të referohemi zonave malore (është tipike mungesa e jodit në organizëm) atëherë do të rikujtojmë arrën. Kjo e fundit ka jod, sidomos kur është në fazat e para të rritjes, përqindja e jodit shkon deri në 60% të frutës dhe 30% e vitaminës C. Me zmadhimin e frutës, bie përqindja e jodit e rritet përqindja e vitaminës C. Nëse vjellim pak nga kokrrat e arrës, i shpojme dhe i konservojmë në mjalte, pasi t'i konsumojmë do të vëmë re efektet e mrekullueshme në rreg-





Gripi është një infeksion viral akut, i cili përhapet lehtë nga njeriu te njeriu. Gripi sezonal është një problem serioz i shëndetit publik, i cili shkakton gjendje të rëndë shëndetësore, shtrime në spital dhe deri në vdekje te grupet me risk të lartë. Problematikat nga gripi mund të jenë shumë të mëdha. Sipas statistikave, ka rreth 170 mijë vdekje nga gripi vetëm në Europë, 22 milionë raste të rënda dhe rreth 3.5 milionë hospitalizime. Gripi ka ngjashmëri të mëdha me ftohjen e zakonshme. Këto janë gjendje, të cilat japin simptoma lokale nga hunda, fyti dhe veshi, si edhe simptoma të përgjithshme, temperaturë dhe ethe. Ftohja e zakonshme dhe gripi mund të paraqiten në disa forma, duke filluar nga ato më lehtë deri te format e rënda. Te ftohja e zakonshme, simptomat e para paraqiten në fytyrë dhe mbesin si simptoma kryesore. Ndërsa te gripi dominojnë: ethet, dhimbja e trupit, mundimi në stomak, plogështia, si edhe simptomat tjera të përgjithshme.

VEPRIMI I VAKSINËS
Vaksina ndaj gripit përmban pjesë inaktive (virus të copëzuar jo të gjallë) të viruseve që mendohet se do qarkullojnë gjatë sezonit. Kundërtrupat fillojnë të zhvillohen në trup dy javë pasi është bërë vaksina dhe mbrojnë ndaj infeksioneve nga viruset, të cilat janë të ngjashme ose të njëjtë me ato me të cilat është prodhuar vaksina. Vaksina ndaj gripit rekomandohet të kryhet çdo vit, për çdo individ nga 6 muaj e lart dhe në veçanti për grupet e riskut. Në grupet e riskut përfshihen gratë shtatzëna, të moshuarit më të mëdhenj se 60 vjeç, të sëmurët me sëmundje kronike, fëmijët e vegjël, si dhe personeli shëndetësor. Vaksinimi ndaj gripit duhet të kryhet përpara, në fillim dhe gjatë sezonit të gripit. Pra, për sa kohë që viruset janë në

Si të parandaloni gripin nëpërmjet vaksinimit

qarkullim, vaksinimi mund të bëhet gjatë gjithë sezonit të gripit. Kundërtrupat e zhvilluara në përgjigje të vaksinës ndonjëherë mund të sigurojnë mbrojtje kundër viruseve të ndryshme të gripit që lidhen me njëri-tjetrin, pavarësisht se nuk përputhet maksimalisht me viruset që qarkullojnë. Miti se vaksina shkakton gripin Vaksina ndaj gripit nuk mund të shkaktojë gripin, pasi ajo nuk përmban asnjë virus të gjallë. Ajo përmban vetëm strukturat sipërfaqësore të virusit dhe jo

pjesëzat infektuese të tij. Mendimi se vaksina shkakton gripin mund të lindë si rezultat i keqinterpretimit të ndodhjeve të lehta të padëshiruara, të shkaktuara pas vaksinimit ose nga infeksionet respiratore të shkaktuara nga viruse të tjera, të cilat mund të shkaktojnë simptoma "të ngjashme si gripi".

SA FUNKSIONON VAKSINA?

Në 10 vitet e fundit, vaksina ka dhënë mbrojtje të mirë ndaj gripit dhe ajo është akoma mënyra më e mirë për të luftu-



“Në 10 vitet e fundit, vaksina ka dhënë mbrojtje të mirë ndaj gripit dhe ajo është akoma mënyra më e mirë për të luftuar atë. Organizata Botërore e Shëndetësisë ka quajtur vaksinimin bashkë me ujën e pijshëm si dy ndërhyrjet që kanë impaktin më të madh te njerëzimi.



ar atë. Organizata Botërore e Shëndetësisë ka quajtur vaksinimin bashkë me ujën e pijshëm si dy ndërhyrjet që kanë impaktin më të madh te njerëzimi. Vaksinimi funksionon. Vaksina është e mirëtestuar dhe ka rezultate të shkëlqyera mbrojtëse. Ndodhi të pakëndshme të rënda nga vaksina ndaj gripit janë shumë të rralla. Ndodhitë më të zakonshme janë pak dhimbje dhe skuqje në vendin e injektimit, që kalojnë pas 1 deri 2 ditë, temperaturë e lehtë dhe kruajtje. Studime të shumta kanë treguar se vitamina C nuk ka asnjë ndikim në parandalimin apo kurimin e gripit. Gripi është një sëmundje që shkaktohet nga virusi i gripit dhe mund t'i ngjitet kujt,do, pavarësisht se sa i fortë mund të jetë sistemi imunitar. Virusit i gripit pëson mutacione, si rrjedhojë vaksinimi i përvitshëm është

të mënyra më e mirë për të krijuar mbrojtjen e duhur ndaj tij. Çdokush mund të sëmurët nga gripi. Ai mund t'ia ngjisë ndonjërit prej grupeve në risk (vulnerable) edhe pa pasur ndonjë simptomë. Personeli shëndetësor është ndër grupet e shëndetshme që duke u vaksinuar mbrojnë jo vetëm veten, por edhe pacientët e të tjerët përreth. Rreth 70% e njerëzve që infektohen me grip nuk kanë simptoma dhe mund t'ia ngjisin sëmundjen të tjerëve (si. psh. grupeve në risk/personelit shëndetësor) edhe pse nuk ndihen të sëmurë. **VAKSINIMI TE GRATE SHTATZËNA**
Vaksina ndaj gripit nuk dëmton bebin e palindur në fakt vaksinimi mbron si fetusin, ashtu edhe gruan shtatzënë. Vaksinimi mund të kryhet gjatë çdo trimestri të shtatzënisë.

Këshilla



Njihuni me 3 ushqimet që ndihmojnë në pastrimin e mushkërive

Mushkëritë luajnë një rol thelbësor në sistemin e frymëmarrjes pasi marrin oksigjenin dhe filtojnë jashtë organizmit toksinat. Ruajtja e shëndetit të mushkërive dhe funksioneve të tyre është thelbësore.

Mushkëritë e shëndetshme garantojnë që i gjithë organizmi të ushqehet siç duhet me oksigjen. Një mënyrë për të përmirësuar shëndetin e mushkërive është që të konsumoni ushqime me aftësi pastruese. Sigurisht që aktiviteti fizik, mospirja e duhanit dhe shmangia e ndotjes janë gjithashtu, mënyra të mira për të garantuar shëndetin e mushkërive. Ushqimet luajnë një rol kryesor për mirëqenien e këtij organi. Barishtet, hudhra, agrumet, frutat e pyllit dhe xhenxhefilij janë ndër ushqimet më të rekomandueshme për shëndetin e mushkërive.

FISTIKËT

Fistikët janë shumë të rëndësishëm për shëndetin e mushkërive. Sipas informacioneve

fistikët përmbajnë një lloj të veçantë të vitaminës E, e cila ofron mbrojtje ndaj disa formave të sëmundjeve të mushkërive. Fistikët ndihmojnë në uljen e kolesterolit dhe të ngopin lehtë e pa kalori, të cilat janë përgjegjëse për shtimin në peshë.

SPECI DJEGËS

Speci djegës është një erëza shumë e fuqishme dhe mirëbërëse për organizmin. Ai ofron me dhjetëra përfitime për shëndetin e njeriut. Speci djegës ndihmon në shuarjen e kollës që irriton fytyrin në vazhdimësi. Ekspertët thonë se speci djegës parandalon problemet me të

ftohurën dhe gripin. Kjo erëza shpërbën sekrecionet dhe rekomandohet për gjithkënd që vuan nga bronshiti apo problemet me rrugët e frymëmarrjes.

USHQIMET E PASURA ME OMEGA-3

Acidet yndyrore omega-3 ndihmojnë në pastrimin e mushkërive dhe efikasitetin e sistemit të frymëmarrjes. Salmoni, sardelet, farat, arrorët dhe vezët janë shumë të pasura me acide yndyrore omega-3.

Këto ushqime kanë gjithashtu aftësinë të shmangin inflamacionin në organizëm dhe të përmirësojnë shëndetin mendor.



Konsumoni lëngun e lakrës kundër ulcerës në stomak

Lëngu i lakrës është një nga pijet më të shëndetshme që mund të konsumoni pasi është i pasur me polifenolë, kalcium, magnez, hekur, fosfor, sulfur, kalium, jod si dhe vitaminat A, B1, B2, B6, C, K por edhe acid folik. Lakra përmban shumë polifenolë ose siç njihen ndryshe si antioksidantë që pakësojnë shfaqjen e sëmundjeve kancerogjene dhe atyre kronike. Minerale të rëndësishme që përmban ky lëng e bëjnë atë të rëndësishëm në mbrojtjen e kockave, por edhe në uljen e tensionit të gjakut. Vitaminat që gjenden tek lakra dhe lëngu i saj janë të dobishme për sistemin riprodhues, atë imunitar, shëndetin e syve por edhe shëndetin e flokëve, lëkurës, mëlçisë, nervave, syve e shumë të tjera. Lakra është një burim i shkëlqyer i vitaminës C që e ndihmon organizmin të jetë më rezistent ndaj baktereve, radikaleve të lira dhe virozave. Ajo përmban më shumë vitaminë C se portokallet, një karakteristikë që e bën lakrën të domosdoshme kundër shumë sëmundjesh.

Lakra është një nga 10 ushqimet më të pasura me vitaminë K, e cila është thelbësore kundër sëmundjeve të zemrës dhe kockave. Lëngu i lakrës trajton ulcerën në stomak, e ka vitaminat dhe minerale forcon rezistencën e shtresës së stomakut ndaj acideve. Lëngu i lakrës përmban antioksidantë që luajnë një rol në detoksifikimin e mëlçisë. Mëlçia luan një rol vendimtar në funksionet e ndryshme metabolike të trupit. Lëngu i lakrës rekomandohet kur e keni tepruar me alkoolin apo jeni helmuar nga ushqimi. Alkooli shkatërron shumë prej baktereve të shëndetshme në stomak dhe vitaminave apo mineraleve. Lëngu i lakrës pastron sistemin tretës sepse përmban shumë ushqyes. Ekspertët rekomandojnë pirjen e një gotë me lëng lakre në ditë me stomak bosh dhe më pas rritjen e dozës në dy gota në ditë. Pini një gotë me lëng lakre në ditë për të shmangur plakjen e parakohshme të lëkurës dhe tharjen e saj. Lëngun e lakrës mund ta përdorni edhe si një maskë lëkure. Nëse dëshironi të hiqni njollat apo të zbusni pigmentimin e lëkurës përzieni një lugë gjelle me mjaltë, pak shafan Indi dhe një çerek gotë me lëng lakre. Më pas shtoni miell orizi dhe përzieni mirë që të krijoni një pastë të mirëfilltë. Lyezi zonat e njollave me këtë pastë, mbajeni për 10 minuta dhe më pas shpëlajeni fytyrën me ujë. Lëngu i lakrës përmban shumë sulfur dhe është shumë efikas për forcimin e flokëve dhe shmangien e rënies së tyre. Pini një gotë me lëng lakre çdo mëngjes dhe përdoreni lëngun edhe si maskë flokësh. Lëngu i lakrës do të plotësojë nevojat ushqyese të trupit dhe do ju ndihmojë të humbisni në peshë, të forconi sistemin imunitar dhe të mbani sëmundjet larg.

Ministria e Jashtme: Fqinjët po manipulojnë dialogun për të arritur marrëveshje

MPJ: Serbia, agresion diplomatik ndaj Kosovës, BE të reagojë

Fushata agresive serbe, kërkohet ndërmjetësimi i ndërkombëtarëve

Ditën e djeshme Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës ka reaguar ndaj fushatës agresive diplomatike të Serbisë ndaj Kosovës, duke i vlerësuar të papranueshme veprimet destruktive dhe standardet e dyfishta që shteti fqinj po i përdor në marrëdhëniet me shtetet njohtëse dhe jonjohëse të vendit Kosovës. MPJ thotë se Serbia po keqpërdor dhe po manipulon me dialogun për normalizimin e plotë të marrëdhënieve në mes dy shteteve, me qëllimin parësor për të bërë agresion diplomatik kundrejt sovranitetit dhe imazhit ndërkombëtar të Kosovës. Në një deklaratë për media, MPJ nënvizon qëndrimin zyrtar se Kosova ka hyrë në dialog me Serbinë me ndërmjetësimin e BE-së, mbështetjen e plotë të SHBA-ve dhe shteteve të tjera aleate dhe partnere, me vullnetin e mirë dhe besimin e plotë për të përmirësuar marrëdhëniet në mes dy shteteve dhe popujve nëpërmjet arritjes së marrëveshjes së detyrueshme ligjore, e cila do të duhej të përfundonte me njohjen reciproke në mes dy shteteve dhe anëtarësimin e plotë dhe të barabartë të Kosovës në OKB. "Për Republikën e Kosovës, dialogu me vullnetin e mirë dhe mirëbesim ka qenë dhe mbetet mënyra e vetme e zgjidhjes së problemeve, ndërtimit të besimit në mes dy shteteve dhe dy popujve, promovimit të paqes afatgjatë, forcimit të stabilitetit rajonal dhe rritjes së prosperitetit për të gjitha popujt, por ai nuk mund dhe nuk duhet të shndërrohet si instrument qëllimi, mjet destruktiv dhe metodë manipuluese nga shteti fqinj, për dëmtimin dhe rrënimin e imazhit të shtetit të ri në marrëdhëniet me jashtë dhe paralelisht me këtë rrezikimin e interesave nacionale të shtetit dhe Kosovës", thuhet në deklaratë.



Ministria e punëve të jashtme të Kosovës

DEKLARATA E MPJ

"Për Republikën e Kosovës, dialogu me vullnetin e mirë dhe mirëbesim ka qenë dhe mbetet mënyra e vetme e zgjidhjes së problemeve, ndërtimit të besimit në mes dy shteteve dhe dy popujve, promovimit të paqes afatgjatë, forcimit të stabilitetit rajonal dhe rritjes së prosperitetit për të gjithë popujt, por ai nuk mund dhe nuk duhet të shndërrohet si instrument qëllimi, mjet destruktiv dhe metodë manipuluese nga shteti fqinj, për dëmtimin dhe rrënimin e imazhit të shtetit të ri në marrëdhëniet me jashtë dhe paralelisht me këtë rrezikimin e interesave nacionale të shtetit dhe Kosovës", thuhet në deklaratë.

KËRKESA E MPJ NDAJ BE-së

"MPJ u bën thirrje përfaqësuesve të BE-së, si ndërmjetësues të dialogut; SHBA-ve si mbështetëse të plotë të tij dhe shteteve të tjera aleate dhe partnere, që të reagojnë menjëherë dhe t'i tërheqin vërejtjen Serbisë kundrejt sjelljeve dhe veprimeve të tilla, që janë në kundërshtim të plotë me zotimin e shprehur për bashkëpunim rajonal dhe vullnetin e shprehur për normalizim të plotë të marrëdhënieve në mes dy shteteve", thuhet në komunikatë.

save nacionale të shtetit dhe shtetasve të Kosovës", thuhet në deklaratë. Për më tepër, MPJ konsideron se veprimet të tilla nga lideri i shtetit fqinj duket se kanë qëllim të lëkundin edhe disponimin pozitiv rajonal për t'u dhënë hapësirë veprimeve gjeopolitike, që kultivojnë shpërputhje me vullnetin rajonal për integrim në BE, NATO, anëtarësimin e Republikës së Kosovës në INTERPOL dhe liberalizimin e vizave për shtetasit e Kosovës. "MPJ u

bën thirrje përfaqësuesve të BE-së, si ndërmjetësues të dialogut; SHBA-ve si mbështetëse të plotë të tij dhe shteteve të tjera aleate dhe partnere që të reagojnë menjëherë dhe t'i tërheqin vërejtjen Serbisë kundrejt sjelljeve dhe veprimeve të tilla, që janë në kundërshtim të plotë me zotimin e shprehur për bashkëpunim rajonal dhe vullnetin e shprehur për normalizim të plotë të marrëdhënieve në mes dy shteteve", thuhet në komunikatë.

Haradinaj: Korrigjimi i kufijve është maskim për ndarjen e Kosovës

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj në një tubim me të rinjtë e AAK-së në Bogë, ditën e djeshme ka deklaruar se pavarësisht marrëveshjes, Serbia po pengon anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare. Njëherësh, korrigjimin e kufijve, demarkimin dhe idenë e shkëmbimit të territoreve, Haradinaj i ka quajtur maskime për ndarjen e Kosovës. "Unë nuk besoj në një marrëveshje me korrigjim të kufijve, me demarkim, me ndërrim të territoreve, krejt janë maskime për ndarjen e Kosovës. Të gjitha këto janë maskime që atje në anën tjetër, shefi i shtetit të vetë thotë 'unë kam nxjerrë diçka, po e pranojmë Kosovën. Edhe nëse thonë po,

Kryeministri i Kosovës: Serbia po pengon anëtarësimin tonë në organizatat ndërkombëtare

e pranojnë sot, se ata s'po i respektojnë marrëveshjet e veta". Edhe kur të shkosh në Këshill të Sigurimit, prapë do t'i thotë Rusisë apo dikujt, bilokojni Kosovën. Pse atëherë të shkojmë në atë rrugë. Jo, po konsolidohemi, bëhemi shtet, po e njohim veten më shumë, po bëhemi të zot", ka thënë Haradinaj. Demarkacionin me Malin e Zi, Haradinaj e quajti korrigjim të marrëveshjes e jo të kufijve. Ai po ashtu tha se është i interesuar të ketë marrëdhënie të mira me Malin e Zi, e për këtë njoftoi që e ka ftuar kryeministrin malazet në kullat e tij në Glllogan. "Nuk jemi

duke korrigjuar kufij, marrëveshje po korrigjojmë, sepse është bërë një marrëveshje gabim për kufirin Mali i Zi-Kosovë. Kufiri është në Qakor, kufiri është në kullë, është bërë gabim në marrëveshje dhe ata kanë rënë dakord në dy drejtime. Këtu falënderoj edhe presidentin Thaçi për kujdesin e tij në atë kohë, kryetarin Veseli edhe secilin që na ndihmuar të kryhet kjo marrëveshje. E kemi kryer demarkimin dhe me kryerjen e rij janë arritur kushtet për liberalizim", ka thënë Haradinaj. Kryeministri Haradinaj foli edhe për ushtrinë e Kosovës, për të cilën tha se

nuk e zëvendëson NATO-n, as KFOR-in, por është mandat mbrojtës i Kosovës. Ai po ashtu tha se kjo ushtri garanton të drejtën e Kosovës për mbrojtje dhe se të rinjtë e Kosovës, përmes ushtrisë do të kenë mundësi të kontribuojnë edhe për paqen në botë. "Kë rrezikon dhe drejta e Kosovës në ushtri, në mandat? Askënd. Pra, është vetëm plotësim i një vakumi, i një të drejte të munguar. Për ju të rinjtë është me rëndësi ushtria jo vetëm që mund të bëheni ushtarë, por për shkak se do të kualifikoheni për të qene shtetas i shtetit tuaj ashtu siç është një shtetas i Maqedonisë, i

Shqipërisë, i Malit të Zi, i Serbisë e i kuitdo tjetër", ka thënë Haradinaj. Lidhur me qeverisjen, Haradinaj tha se ajo duhet të zbatohet e jo vetëm të bëhen politika. Ai tha se qeveria e tij ka për fokus rendin, ligjin dhe sigurinë në Kosovë. "Puna e parë që është dashur të kryejmë, është që Kosovës t'i vijë era shtet, rend, ligj dhe siguri. Çka nënkupton kjo? Një shtet që s'ka gjyqësor, nërëziti nuk besojnë të drejtësia dhe atëherë e kemi punën keq, nuk të beson as investitori i huaj. Ju e dini, gjyqtarët e Kosovës sot i kanë pagat dy mijë euro", ka thënë Haradinaj. Gjatë këtij takimi, Haradinaj po ashtu potencoi çështjen e ambientit. Ai tha se ata qytetarë që gjuajnë bërllug do të dënohen, e paratë e fituara nga gjობat, Haradinaj tha se do t'i shkojnë policisë për t'i stimuluar.

SHKURT

Greqi, dy lëkundje tërmeti në ishullin Zante

Du lëkundje në harkun e 7 minutave janë regjistruar në ishullin grek të Zantes, i goditur në 26 tetor nga një tërmet me magnitudë 6.4. Nuk ka raportime për viktima apo dëme materiale. Instituti gjeodinamik i Athinës bën me dije që lëkundja e parë ka qenë 4.4 ballë dhe është regjistruar në orën 05:11 me orën lokale, me epiqendrë 78 kilometra në jug të Zantes dhe me një thellësi 10 km. Shtatë minuta më pas, një tjetër lëkundje me magnitudë, 5.0 ka goditur sërish ishullin me epiqendrë rreth 59 km në jug-perëndim të ishullit dhe thellësi 7 km. Nga tërmeti i 26 tetorit ka pasur rreth 21 lëkundje me magnitudë nga 4.0 deri në 5.5 ballë.

Presheve, zgjedhje për këshillin kombëtar

Në Serbi zhvillohen sot zgjedhjet për këshillat rajonale të pakicave kombëtare. Mbi 36 mijë votues janë thirrur për të marrë pjesë në zonat e populluara nga shqiptarët në Presheve, Medvegje dhe Bujanovc. Në garë janë 6 parti shqiptare. Sipas ligjeve serbe, këshillat komunalë trajtojnë kryesisht çështjet e të drejtave të pakicave kombëtare në arsim, informim, kulturë e simbole.

Radikalët francezë kryesojnë në sondazhe

Nacionalistët e djathtë francezë kryesojnë për të parën herë sondazhet në prag të zgjedhjeve për Parlamentin Europian të majit 2019. Sipas Institutit Francez për Opinionin Publik, koalicioni partive të djathta radikale "Manifesti Kombëtar" i kryesuar nga Marine Le Pen ka pësuar rritje në 21%, 4 pikë më shumë se mbështetja e mëparshme. Ndërsa partitë e koalicionit Republika në Marshim, i Presidentit Emanuel Makron kanë humbur 1 pikë krahasuar me presidencialët e 2017-ës, duke rënë në një mbështetje me 19%. Mbështetja në rritje vihet re në gjithë Europën për partitë e spektrit të djathtë radikal. Zgjedhjet rajonale të tetorit në Gjermani i siguruan Alternativës për Gjermaninë përfaqësimin në parlamentet e të 16 shteteve federale. Edhe në Itali, zgjedhjet e pjesshme lokale forcaun pozitativ e Lega Nordit të zv.kryeministrit Matteo Salvini. Analistët thonë se këto parti që i bashkon fryma kundër emigrantëve pritet të kenë një zë tepër të fuqishëm në legjislaturën e re europiane.

Kaledonia e Re voton kundër pavarësisë nga Franca

Referendumi për sovranitet të plotë, 57% e banorëve kundërshtojnë ndarjen nga shteti francez

Kanë qenë rreth 57 për qind e votuesve në referendumin për pavarësi të rajonit autonom francez të Kaledonisë së Re, të cilët votuan "kundër" pavarësimin nga Franca - transmeton " Anadolu Agency" (AA). Rreth 174 mijë votues të Kaledonisë së Re, që ndodhet në juglindje të Oqeanit Paqësor, votuan për "të qenë pjesë e Francës apo për shtet i pavarur". Pjesëmarrja në referendumin për pavarësi ishte 80 për qind, ndërkaq deri më tani janë numëruar 95 për qind të votave. Sipas rezultateve



jozyrtare, 56.8 për qind të votuesve janë "kundër" pavarësimin nga Franca. Qytetarët e Kaledonisë së Re iu përgjigjën "kundër" pyetjes se "A dëshironi sov-

ranitet të plotë dhe pavarësimin e Kaledonisë së Re". Me këtë, ata refuzuan shpërbërjen nga Franca. Në bazë të marrëveshjes së arritur me Francën, mbështetësit e pavarësisë mund të shkojnë edhe në një referendum të ri para vitit 2022. Kaledonia e Re përfaqësohet me dy deputetë dhe dy senatorë në parlamentin francez dhe çdo vit merr 1.3 miliardë euro mbështetje financiare nga Franca. Presidenti i Francës, Emmanuel Macron në maj vizitoi Kaledoninë e Re, e cila ka një

rëndësi strategjike për shtetin e tij. Me këtë rast ai tha se "Franca është më pak e bukuro pa Kaledoninë e Re". Kaledonia e Re në vitin 1853 është aneksuar nga Franca. Që nga kjo datë e deri në vitin 1946 ishte zonë koloniale. Ndërsa deri në vitin 2003 Kaledonia e Re ishte pjesë e Komunitetit të Rajoneve tejetdare të Francës. Me ndryshimet kushtetuese të vitit 2003, Kaledonia e Re u bë një rajon autonom pranë Francës. Kaledonia e Re ka një sipërfaqe prej 18.576 kilometra katrorë dhe 275.000 banorë. Frëngjishtja është gjuha zyrtare në këtë vend, ndërsa kryeqyteti i saj është Noumea.

SHKURT

Zgjedhjet në SHBA, intensifikohet sfida për mandatin

Në Shtetet e Bashkuara është intensifikuar sfida mes demokratëve dhe republikanëve për zgjedhjet e mes mandatit. Në terren me tubime të ndryshme ka zbritur edhe ish-presidenti Obama, i cili sulmoi kreun aktual të Shtëpisë së Bardhë, por edhe Trump e ka kritikuar atë. Mbeten vetëm pak ditë para zgjedhjeve të mesit të mandatit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Presidenti Donald Trump ka intensifikuar pjesëmarrjen në tubime dhe ka në plan të vazhdojë këshu deri ditën e zgjedhjeve më 6 nëntor. Por, nga ana e demokratëve, figura si ish-presidenti Barak Obama, ish-nënpresidenti Joe Biden, madje edhe Oprah Winfrey janë angazhuar gjithashtu nëpër tubime para zgjedhore. Vetëm pak orë kanë ngelur deri ditën e zgjedhjeve për në Kongres. Presidenti Trump dhe ish-presidenti Obama kanë folur nëpër tubime, duke theksuar të dy rëndësinë e zgjedhjeve të ardhshme, por edhe duke sulmuar njëri-tjetrin. "Këto zgjedhje do të vendosin nëse do të vazhdojmë me zhvillimin e jashtëzakonshëm që kemi parë, apo nëse do t'i lejojmë demokratët radikalë të marrin kontrollin e Kongresit", tha presidenti. "Këtë herë zgjedhjet janë shumë të rëndësishme. Pasojat e të qëndruarit pa votuar janë të mëdha", shtoi ai. Ndërsa të premtën, lajmi i uljes së papunësisë shërbeu si adrenalinë për Trumpin. Raporti i së premtës për punësimin tregonte se 250 mijë vende pune janë shtuar në tetor dhe se pagat janë rritur me shpejtë brenda një deкаде. Ish-presidenti Obama dikur ngurronte të fliste kundër pasardhësit të tij, por duke iu përgjigjur shifra të punësimit në një tubim në shtetin e Xhorxhias tha: "Më duhet ta shpjegoj se republikanët tani thonë 'shikoni sa mirë është ekonomia'. Nga mendoni se erdhni kjo?". Presidenti Trump dhe ish-presidenti Obama kanë pikëpamje të ndryshme për sa i përket çështjes së imigracionit. "Ata duan që këto karvanë të mbushur me njerëz që vijnë në mënyrë të jashtëligjshme të vërshojnë në vendin tonë, duke rrezikuar komunitetin tuaj", tha presidenti Trump. "Ata po ju tregojnë se kërcënimin ekzistencial për Amerikën është një bandë refugjatësh të varfër një mijë larg", u shpreh ish-presidenti Obama. Ndër të tjera, ky i fundit nënvizoi se, "Trump është një gënjeshtar, i cili mbjell urrejtje dhe frikë".

E tmerrshme në Palermo, vdesin 9 anëtarë të një familjeje

Tjetër tragjedi nga moti i keq në Itali

Përmbytjet në Sicili, humbin jetën 12 persona

Vijojnë përmbytjet e fatkeqësitë që i shoqërojnë katastrofat natyrore nëpër Europë. Kësaj radhe momentet e tmerrit janë duke e përjetuar banorët e Italisë. Po u referohemi pikërisht momenteve të vështira që përjetuan shumë banorë të Sicilisë si pasojë e përmbytjeve të furishme që u morën jetën 12 personave brenda një nate, asaj mes të shtunës dhe të dielës. Ngjarja më e rëndë ishte ajo në fshatin Kasteldaccia pranë Palermos, ku 9 anëtarë të një familjeje që jetonin në këtë banesë humbën jetën. Mes viktimave dy fëmijë 3 dhe 15 vjeç. Uji i një përroi që kalonte pranë banesës së tyre u fry dhe përmbiti furishëm të gjithë zonën pranë shtratit. Përmbytjeve u shpëtuan vetëm 3 pjesëtarë që ndodheshin jashtë banesës, të cilët hipën nëpër pemë. Ndërkaq, një muaj më parë ujërat e rrëmbyer përmbytën edhe zonën historike të Palermos. Banorët thanë se kurrë nuk kanë parë një situatë të tillë. Autoritetet kërkuan ndërhyrjen e ushtrisë. "Apokaliptike" situata edhe në veri, në rajonin e Venetos, ku përmbytjet e rrëshqitjet e tokës kanë shkatërruar pyje e kanë lënë pa energji elektrike mbi 5 mijë familje. Moti i keq ka mbërthyer prej disa javësh të gjithë Italinë, duke shkakuar dhjetëra viktima e dëme prej miliona eurosh. Reshje të dendura shiu dhe erëra të forta u përplasën sidomos mbi Kaljari, u një grua që konsiderohej e zhdukur, është gjetur e pajetë. Një mbikalim u shemb pjesërisht prej shiut të rrëmbyeshëm, ndërkohë që shkollat, muzetë, bibliotekat mbeten të mbyllura. Ndërkaq, në ishullin spanjoll të Majorkës, ekipet e shpëtimit janë duke kërkuar



një djalë 5-vjeçar dhe dy pushues gjermanë, të cilët rezultojnë të zhdukur pas një vërshimi të befasishtëm ujërash. Dy trupa të pajetë u gjetën në jug të Francës në një makinë të përmbysur pranë qytetit Sainte-Maxime. Duket se bëhet fjalë për një prej disa automjeteve të tërhequra nga ujërat e lumit Garonnette, niveli i të cilit u rrit ndjeshëm pas shirave të dendur në zonë gjatë natës. Stuhitë janë pjesë e një fronti të ftohtë që është zhvendosur nëpër Mesdhe duke marrë të paktën 12 jetë njerëzish në Majorka, mes të cilëve edhe dy turistë britanikë. Punonjësit e ndë-

rhyrjes së shpejtë kanë mundur të shpëtojnë gjithsej 16 persona. Përmbytje kanë ndodhur edhe në Francë, ku disa nga vdekjet ishin në qytetin e Trebes, i cili qëndron midis një kanali dhe dy lumenjve, duke përfshirë edhe Audenë. Të paktën 10 vetë vdiqën në Francën Jugperëndimore, kur u regjistruan përmbytjet më të mëdha të shekullit, me lumenjtë që dolën nga shtrati dhe vërshuan mbi shtëpi e makina. Vetëm brenda disa orëve të natës ra më tepër shi se në 7 muajt e fundit, duke i kapur banorët në befasi, pasi ishin duke fjetur dhe duke izoluar fshatrat,

thënë zyrtarët lokalë. Ndërsa numri i të vdekurve u rrit dhe shkalla e dëmeve u bë e qartë, presidenti Emmanuel Macron vendosi të bëjë një riorganizim tashmë të vonuar të kabinetit të tij. "Është si një zonë lufte. Fshatit është pak a shumë i izoluar nga bota e jashtme", tha Jean-Jacques Garros, një banor i Villegailhenc. Macron tha në një konferencë të përbashkët për shtyp me kreun e Koresë së Jugut Moon Jae-in në Paris, se mendimet e kombit francez ishin me viktimitë dhe familjet e tyre. Kryeministri Edouard Philippe udhëtoi në zonën e fatkeqësive për t'u takuar me

personelin e shërbimit emergjent. Rreth 350 zjarrfikës u përfshinë në operacionet e shpëtimit, një numër që do të dyfishohet. Pamjet televizive treguan lumenjtë me baltë që kishin shkullur pemët, rrëzuar shtyllat e energjisë elektrike dhe gërryer rrugët në rajonin jugor të Audesë, pranë qytetit mesjetar të kodrës Carcassonne. Nëntë helikopterë punuan për të shpëtuar njerëzit nga çatitë e shtëpive të tyre, por operacionet kanë qenë të komplikuar për shkak të ashpërsimit të motit, ndërsa raportohen mijëra njerëz të evakuuar nga zona.

DEMET

Një mbikalim u shemb pjesërisht prej shiut të rrëmbyeshëm, ndërkohë që shkollat, muzetë, bibliotekat mbeten të mbyllura. Ndërkaq, në ishullin spanjoll të Majorkës, ekipet e shpëtimit janë duke kërkuar një djalë 5-vjeçar dhe dy pushues gjermanë, të cilët rezultojnë të zhdukur pas një vërshimi të befasishtëm ujërash.

Dje në "Deutsche Welle"

SHBA, sanksionet më të ashpra ndonjëherë kundër Iranit

Nga Matthias Hein

(vllon nga faqja 1)

CILAT SANKSIONET KUNDËR IRANIT HYJNË NË FUQI?

... bizneset e ndryshme në shoqëritë iraniane të naftës. Edhe sigurimet e të gjitha llojeve janë të ndaluara, edhe ato të transporteve të naftës. Në të njëjtën kohë do të shtohen edhe sanksionet për sektorin financiar. Kështu, do të ndalohen të gjitha transaksionet financiare me Bankën Qendrore Iraniane dhe banka të tjera iraniane. Presidenti Trump i ka quajtur këto sanksione "më të ashprat e të gjitha kohërave". Eksporti iranian i naftës duhet të zerohet, sipas vullnetit të qeverisë amerikane. Edhe nëse kjo nuk arrihet plotësisht, çdo lloj kufizimi i ri eksportit të naftës do të ishte i dhimbshëm për Iranin. 80% e të ardhurave shtetërore të Iranit e kanë origjinën në shitjen e naftës.

CILAT SANKSIONE JANË NË FUQI?

Pas daljes së njëanshme të SHBA-ve nga marrëveshja atomike - "Joint Comprehensive Plan of Action", shkurt JCPOA, SHBA u vendosi afate partnerëve të Iranit për të reduktuar bizneset e tyre. Afati i parë prej 60 ditësh përfundoi më 6 gusht. Pas kësaj, Iranit u bllokua mundësia e aksesit tek dollari amerikan. Edhe industri të tjera të rëndësishme iraniane si ajo e automobilitave dhe qilimave u vendosën nën sanksione. Afati i dytë merr fund më 5 nëntor.

CILI ËSHTË QËLLIMI I SANKSIONEVE?

Sipas qeverisë amerikane, me sanksionet duhet të ushtrohet maksimalisht presion ndaj Iranit. Sekretari i Departamentit Amerikan të Shtetit, Mike Pompeo në një fjalim më 21 maj paraqiti një listë me 21 kërkesa që duhet të përmbushen për të mënjnauar sanksionet. Irani duhet të dorëzojë programin e tij të raketave, të mos mbështesë më grupet terroriste në Lindjen e Mesme, përfshirë edhe Hizbollahët, Hamasin dhe grupin Xihadi Islamik Palestinez. Ky vend duhet të tërheqë të gjitha trupat nën komandon iraniane nga Siria dhe kërkojë çmbilizimin e milicëve shiitë në Irak.

Rrëzimi i qeverisë iraniane nuk është qëllim i shpallur zyrtarisht i sanksioneve. Por deklaratat e këshilltarit të presidentit amerikan për sigurinë, John Bolton të lenë të kuptosh se destabilizimi i Iranit dhe ndërrimi i regjimit në Teheran do të ishin të dëshiruara.

SI REAGONJË PARTNERËT E TJERË NË MARRËVESHJES ATOMIKE?

Partnerët e tjerë të marrëveshjes atomike, si Gjermania, Franca, Anglia, Kina dhe Rusia e kanë dënuar largimin e njëanshëm të SHBA nga marrëveshja atomike. Ata duan ta respektojnë mar-



rëveshjen për të cilën u deshën 12 vjet të arrihej. Qëllimi marrëveshjes do të arrihej sipas tyre, pra mënjanimi i rrezikut që Irani të armatohej me armë nukleare. Qëndrimi politik i Iranit në rajon nuk ka qenë asnjëherë pjesë e marrëveshjes. Edhe Irani dëshiron të respektojë marrëveshjen, por vetëm nëse përfiton nga avantazhet që parashiheshin në të. Këtu bënte pjesë edhe shkëmbimi ekonomik me vendin e dobësuar nga sanksionet. Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike rregullisht ka konfirmuar se Irani i respekton kushtet e marrëveshjes atomike.

MUND BE TË MBROHET KUNDËR SANKSIONEVE AMERIKANE?

SHBA-të e përdorin rolin e tyre

drejtues në tregjet financiare, që dallon ndjeshëm nga atraktiviteti për tregun iranian, si një mjet për të arritur qëllimet politike. Prandaj janë shumë të vështira masat kundër rregullimit de-facto nga Uashingtoni të sipërmarrjeve europiane dhe ndërkombëtare. Në fund të shtatorit, e ngarkuara e BE për Politikën e Jashtme, Federica Mogherini u shpreh në kuadër të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme për krijimin e një institucioni të veçantë për kryerjen e bizneseve me Iranin, një të ashtuquajtur "Special Purpose Vehicles" (Mekanizëm special i qëllimit). Ky mekanizëm duhet të funksionojë si një bursë këmbimi dhe kërkesat e firmave iraniane dhe europiane duhet të llogariten brenda këtij

Sipas qeverisë amerikane, me sanksionet duhet të ushtrohet maksimalisht presion ndaj Iranit. Sekretari i Departamentit Amerikan të Shtetit, Mike Pompeo në një fjalim më 21 maj paraqiti një listë me 21 kërkesa që duhet të përmbushen për të mënjnauar sanksionet. Irani duhet të dorëzojë programin e tij të raketave, të mos mbështesë më grupet terroriste në Lindjen e Mesme, përfshirë edhe Hizbollahët, Hamasin dhe grupin Xihadi Islamik Palestinez. Ky vend duhet të tërheqë të gjitha trupat nën komandon iraniane nga Siria dhe kërkojë çmbilizimin e milicëve shiitë në Irak.

HOROSKOPI

DASHI

Nuk do të mungojnë debatet sot me partnerin. Shkak mund të jetë një person i tretë, i cili i ka ngatërruar gjërat mes jush. Në dashuri duhet të tregoheni më tolerant dhe mirëkuptues.

DEMI

Në goftë se jeni çift, mbrëmja do ju dhurojë humor dhe mirëkuptim të shkëlqyer me partnerin. Në familje do ju duhet të përballoni disa situata të vështira financiare, të cilat do të zgjidhen shpejt.

BINJAKET

Mëngjesi parashikohet të jetë pak i zymtë për shkak të mungesës së njeriut që e doni shumë. Përpiquni të mendoni pozitivisht. Në mbrëmje parashikohen ftesa nga persona mjaft interesantë.

GAFORJA

Në fushën e ndjenjave reflektoni mirë para se të shkëputeni nga një marrëdhënie që ju intereson dhe që ka baza të forta. Bëni mirë të tregoheni të kujdesshëm, sepse intuata juaj sot mund të dështojë.

LUANI

Keni nevojë për një fillim të ri në çdo aspekt. Merrni gjërat në mënyrë graduale, sepse në xitim e sipër mund të gaboni. Problemet me personat që ju rrethojnë nuk do të mungojnë sot, sidomos në punë.

VIRGJERESHA

Në aspektin financiar, gjërat duket se po lëvizin me shpejtësi. Një propozim pune mund të jetë me shumë leverdi, ndaj merreni në konsideratë. Në dashuri mirëkuptimi me partnerin do të jetë i shkëlqyer.

PESHORJA

Nëse jeni duke menduar të realizoni një investim, bëni mirë që të prisni edhe pak kohë, sepse nuk favorizoheni nga aspekti financiar. Kjo është diçka kalimtare, sepse shumë shpejt mund të keni sukses me paratë.

AKREPI

Shumë prej jush do të ndihen nervozë, të mërzitur nga rutina dhe pengesat e ndryshme. Përpiguni ta kaloni këtë fazë duke u marrë me sport. Ndonjëherë besimi i tepërt në vetvetë mund të jetë mjaft i rrezikshëm.

SHIGJETARI

Sot karakterizoheni nga momente stresi dhe ankthi. Mundohuni të qetësoheni, duke dëgjuar një muzikë glohëse dhe shumë motive irlituese do të zhduken si me magji.

BRICJAPI

Një ditë e mbushur me surpriza të këndshme parashikohet për të lindurit në shenjë tuaj. Një darkë me miqtë tuaj do të jetë tërheqëse për të ngritur nivelin e humorit.

UJORI

Yjet ju favorizojnë duke krijuar një energji pozitive rreth jush. Nëse jeni duke aplikuar për punë, shanset janë që të keni fat. Do të merrni lajme mjaft të mira edhe në çështjet e dashurisë.

PESHQIT

Momente të këndshme parashikohen për të dashuruarit. Kjo nuk mund të thuhet edhe për sektorin e punës. Disa sfida do të duhet t'i kaloni me shumë zgjuarsri falë mbështetjes së disa kolegëve.

Botërori i peshëngritjes në Turkmenistan

Calja e mbyll i gjashti, premtori më shumë për më tej



Peshëngritësi shqiptar, Briken Calja u rendit i 6-ti në Kampionatin Botëror të Peshëngritjes, që u mbajt në Turkmenistan. Kampioni në fuqi i Europës nuk ia doli të merrte asnjë medalje në këtë Botëror, gjithsesi ishte një paraqitje e kënaqshme, duke pasur parasysh gjendjen fizike të peshëngritësit si dhe konkurrencën.

Nëpërmjet një postimi në "Facebook", Calja tregon se "fitorja" në këtë kampionat është mposhtja e kampionit olimpiq dhe thyerja e 5 rekordeve kombëtare. 28-vjeçari premtori se do të vazhdojë të derdhë "gjak" e djersë për Shqipërinë dhe flamurin kombëtar, me të cilin ai është shumë i lidhur. "Vendi i 6-të në Kampionatin Botëror! Një paraqitje e kënaqshme dhe rezultat mjaft i mirë duke pasur parasysh gjendjen time fizike dhe konkurrencën e fortë në peshën deri në 73 kg. Një fitore më vete është mposhtja e ka-

mpionit olimpiq dhe thyerja e 5 rekordeve kombëtare, edhe pse në gjendje jo të mirë fizike. Falënderim i veçantë për doktorin më të mirë, Gjeorgjian Gio Tchintcharauli, falë të cilit u riktheva në garë përsëri për shkak të dëmtimit që kisha në kof-

shë. Gjithashtu, faleminderit stafit tim për punën e palodhur, Sokolin & Geraldin. Faleminderit 'Cufo Fitness Center & Mojo Production', Federatës së Peshëngritjes. Mbi të gjitha një falënderim të madh familjes sime. Do të vazhdoj të derdh gjak e djersë për këtë vend dhe këtë flamur, të nderoj të gjithë ata që më kanë përkrahur në këtë rrugëtim. Ju falënderoj të gjithëve për mbështetjen!".

Berisha titullar në portë, sikundër edhe Strakosha. Gjimshiti nuk aktivizohet asnjë minutë

Legjionarët shkëlqejnë në Itali dhe Zvicër, keq Basha e Mavraj

Shqiptarët e Zvicrës nuk luajnë në humbjen e Arisit



Jeton Selimi

A talanta fitoi me përmbyse sfidën e javës së 11-të në Serbia A, në shifrat 1-2, në transfertë ndaj Bolonjës. Etrit Berisha ishte titullar, por që në minutën e tretë vendësit shënuan me Mbaje. Gardianit shqiptar i kaloi topi te dora, por afërsia e madhe me kundërshtarin nuk i la shumë kohë që të reagonte dhe të ndalte pësimin e golit. Gjithsesi, në pjesën e dytë erdhi edhe përmbyssa e madhe për ekipin e Gasperinit. Mansini në të 57-tën barazoi shifrat me një goditje me të majtën brenda zone, ndërsa në minutën e 70-të ishte Duvan Zapata, që përfitoi nga një top i mbetur në zonë, për të kthyer ndeshjen. Për shqiptarin tjetër, mbrojtësin Berat Gjimshiti, nuk pati asnjë minutë në dispozicion. Kjo ishte fitorja e tretë radhazi për Atalantën dhe tashmë e sheh veten në vendin e 10-të të klasifikimit me 15 pikë, ndërkohë që Berisha është kthyer titullar në portë. Edhe Tomas Strakosha ka qenë titullar në fi-



toren e Lacios me rezultatin 4-1 ndaj SPAL-it. **LEGJIONARËT E ZVICRËS**
Janë luajtur ditën e sotme pjesa e mbetur e ndeshjeve

të javës së 13-të të Super Ligës zvicerane. Bazeli i Taulant Xhakës arriti që të fitonte me vështirësi përballë skuadrës së Luganos me rezultatin 3-2. Ndërsa

për t'u theksuar vlen të përmendet pozicioni i lojtarit të Kombëtares, Xhakës, i cili ka luajtur si mbrojtës qendror. Ndërkohë, në ndeshjen tjetër midis Luzernit dhe Zyrhut kanë qenë këta të fundit që kanë fituar me rezultatin 2-5. Në këtë ndeshje pati një shkëlqim të dy lojtarëve shqiptarë, Toni Domgjoni dhe Benjamin Kololli. I pari që kaloi në avantazh Zyrhuhun ishte Domgjoni me një supergol të shënuar nga distanca. Ndërkohë, në këtë ndeshje ka qenë edhe Benjamin Kololli, i cili shënoi golin e tretë për skuadrën e tij dhe asistoi të katërtin. Në ndeshjen midis Sionit dhe St. Gallen nuk pati shumë histori, me këta të fundit që fituan me rezultatin 0 me 1. Nga minuta e parë në këtë sfidë

luajti si gjithnjë Emir Lenjani si një mesfushor i krahut të majtë. **MAVRAJ DHE BASHA**
Arisi i dyshes Basha-Mavraj është futur në një krizë të thellë rezultatesh. Verdhezinjtë janë mposhtur me rezultatin 0-1 ndaj Olimpiakosit në takimin e vlefshëm për javën e 9-të të kampionatit grek. Golin për miqtë e shënoi Hasan në minutën e 67-të. Si Migjen Basha, ashtu edhe Mërgim Mavraj nuk janë preferuar nga trajneri në këtë përballje duke ngrohur stolin. Për skuadrën nga Selaniku kjo ishte humbja e 4-t radhazi në kampionat, duke iu larguar gjithnjë e më shumë zonës që të çon në Europë. Sfidën e radhës Aris do e luajë në transfertë ndaj Smyrnit të vendit të fundit.

"TRE LUANËT"

Suthgejt grumbullon Rinin, mediat e kryqëzojnë

Trajneri i Kombëtares së Anglisë, Gareth Southgejt ka grumbulluar edhe sulmuesin veteran, Uejn Runi për ndeshjet e ardhshme të "Tre Luanëve" britanikë. Por në mediat britanike, grumbullimi i sulmuesit që tashmë luan në Amerikë me DC Junajtid ka qenë më shumë për "Lajme gazetash", sesa një grumbullim i menduar mirë dhe që mund t'i vlejë skuadrës. Kjo për shkak se Runi ka 119 ndeshje me fanellën e "Tre Luanëve" dhe në rast se aktivizohet, do të arrijë një numër jubilar, atë të 120 ndeshjeve me fanellën e kombëtares. Të njëjten mundësi e kishte edhe mesfushori Dejvid Bekam, por e refuzoi thirrjen nga kombëtarja e tij, pasi nuk pranoi të grumbullohej thjesht për numra, por që të japë kontributin e tij për Anglinë. Runi ka bërë të kundërtën dhe ka pranuar të grumbullohet me Kombëtares e Anglisë dhe me shumë gjasë do të luajë në takimin kundër Amerikës.

Java e 12-të e Superiores

FSHF bën lëmsh kalendarin, shtyhet Laçi-Skënderbeu



situatë absurde, edhe pse jemi në Kategorinë Superiore, kampionatin që FSHF-ja duhet të japë shembullin se e organizon më së miri.

SUPERLIGA		
JAVA E 12-të		
TE MARTEN		18:00
Tirana - Kukësi		
TE MIERKËTËN		14:00
Kastrioti - Partizani		14:00
Kamza - Teuta		17:00
Flamurtari - Luftëtari		?
Laçi - Skënderbeu		
RENDITJA		
Skuadra	N	P
Skënderbeu	11	26
Partizani	11	25
Kukësi	11	19
Laçi	11	19
Flamurtari	11	18
Teuta	11	18
Tirana	11	9
Luftëtari	11	9
Kamza	11	8
Kastrioti	11	4

KRIZA E MONAKOS

Tifozët kundër Henris dhe lojtarëve


Klubi i Principatës, Monako, vazhdon të marrë rezultate negative dhe situata nuk duket aspak e qetë në klubin francez. Edhe pse larguar trajnerin Zhardin dhe emëruan Tierrri Henri në krye të pankinës, rezultatit nuk kanë ndryshuar dhe tashmë bardhekuqtë rrezikojnë seriozisht rënien nga kategoria. Po jo vetëm kaq, pasi tashmë edhe tifozët i ka kundër. Pas humbjes së mbrëmshme në transfertë, tifozët kanë zbritur në fushë dhe kanë debatuar me tone të ashpra me tra-



jnerin Henri dhe me lojtarët. Flitet se një nga tifozët ka goditur kapitenin Falkao, por nuk ka ende pamje filmike të këtij incidenti. Mësohet se trajneri Henri u ka premtuar tifozëve që udhë-

tuan drejt Reims se Monako do të rikthehet më e fortë se kurrë dhe se nuk duhet diskutuar aspak rënia nga kategoria, që tashmë është kthyer në shqetësimin më të madh të tifozëve.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Një pije freskuese.
- Graf ish teniste.
- Dada, ish-diktator i Ugandës.
- Eshhtë pasuri e investuar.
- Mund të jenë fetare.
- Një pjesë e relacionit.
- Fillojnë ambalazhimin.
- Një vegël.
- Qe harkëtar i famshëm i akajeve.
- Fillojnë hetimin.
- Një atentator vëtvërsasës.
- Kështu janë takimet zyrtare.
- Eshhtë anije me dy skafë.
- Fundi i Turandot.
- Iniciolet e Reitman regjisor.
- Farrell regjisor.
- Schneider që qe aktore.
- Mund të jetë e lirë për hartim.
- Emri i Pasternak.

- Ekberg e La dolce vita.
- Dikur qubej Mediolanum.
- Ruajnë pa ujë.
- Një mund të jetë kalendari.
- Një është meskini, shpirtngushti.
- Një hidrokarbur.
- Mund të jetë franceskan.

VERTIKAL

- Jessica Parker aktore.
- Zola shkrimtar.
- Janë dritë të tilla me parsec.
- Mund të jenë gjaku.
- United Kingdom.
- Eshhtë njeri me principe.
- Një polimer për kirurgji estetike.
- Kufizojnë takimet.
- Diftong teatral.
- Fillojnë fluturimin.
- Makina Uno.
- Eshhtë shpend lagune.
- Eshhtë operator që bën zoom.
- Eshhtë i pashpirt.
- Parashtesë për një.
- Pak enigmatike
- Një pjesë e Toskërisë.
- Agustini ish-bomber.
- Kufizojnë një princip.
- Miku i Batman.
- Tapeti për judo.
- Janë stadet në videogame.
- Bëhet një kundër vendimit.
- Janë me blerim mbuluar në një film
- Eshhtë shtet aziatik.
- Papavrami violinist
- Fadili komik
- Përrshëndetja e Jul Qezarit.
- Mbyllin fushatat.
- Mund të jetë e lirë për ketër.
- Mbyllin një takimim.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

- Një pemë gjigante.
- Janë për të kërcyer.
- Ishtë shkollë e Aristotelit
- Një thirrje me emra.
- Gjysmë rivale.
- Një pjesë e narkotikëve.
- Një tis... mjegulle
- E famshme ajo e Keopsit
- Mbyllin një sirtar
- Eshhtë ngjyrë e... fytyrës.
- Fillojnë lejen.
- Janë aktorë kryesorë.
- Janë kompozime të kënduara.
- Hudson aktore.
- Satelit i Uranit.
- Fillojnë tatëpjepën.
- Mbetur në fund.
- Sapo fillojnë.
- Kastile janë në fund.
- Kufij takimi.


- Ekstremet e tokës.
- Iniciolet e Einstein.
- Qendër mësimi.
- Kështu thirrje Marco Pantani.
- Pak irredentizëm
- Fundi i një filmi.
- Popullojnë qytetin.
- Janë gojë vullkanesh
- Eshhtë edhe ai Persik.

VERTIKAL

- Mund të jetë sekrete në derë.
- Makina Agila.
- Ami i Maupassant.
- Mbyllin një sirtar.
- Rrëzohen me strike
- Luciano tenor i paharruar.
- Mbyllin këndet
- Eshhtë borxh.
- Mbyllin portat.
- Hagen rockstar.
- Një pjesë e akademisë.
- Bien me ballë.
- Një barkë lëkurëkuqsh.
- Atje ku shkon progresisti
- Pallati i Dalai Lamas në Lhasa
- Një pjesë e minoritetit.
- Eshhtë fluturues në ufo.
- Do të bëhen mace të tilla.
- Fletë pa kufij.
- I ka tek rendi.
- Kreshniku i volejbollit.
- Një det që është liqen në fakt.
- As unë, as ai.
- Në mes të King edhe Cole të muzikës.
- Një parashtesë zmadhuese.
- Eshhtë lon papagalli.
- Titulli i Sean Connery.
- Fillojnë panikun.
- Gjysma e rojave.
- Fitim pa kufij.
- Mbyllin një sherr.
- Fillojnë një metodë.
- Kufizojnë botimet.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

4	2		5				7		
			4	6			1		5
	6		9	1				3	
6		2		8			4	5	
7		5	2				9	6	
9	4		7						
	5			7			3		
3			6		1		8	2	
		9							

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

2	5	8	4	1	6	3	9	7	
6	4	9	7	5	3	2	8	1	
7	3	1	9	8	2	6	4	5	
5	1	2	3	6	9	4	7	8	
9	8	3	5	4	7	1	2	6	
4	7	6	8	2	1	9	5	3	
3	6	4	2	7	8	5	1	9	
1	2	7	6	9	5	8	3	4	
8	9	5	1	3	4	7	6	2	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Njerëzit ndryshojnë nga njëri-tjetri nga koka, jo nga këmbët
- Më i forti i njerëzve është ai që është i zoti të përmbajë vetveten
- Njeriu duhet të përpiqet të mësojë çdo gjë, jo të tregojë veten e tij
- Kush pëlqen trëndafilin duhet të durrojë edhe gjembat
- Shkalla e parë e marrëzisë është të kujtosh se je i mençur
- Fjalët dhe punët e njerëzve të mëdhenj nuk janë sipas vendit e kohës së tyre, ata mund t'i përshatën çdo kohë dhe çdo vendi.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

8	A	1	11	16		7	5	15	8		3	8	
1	Z	8	13	8	6		6	8		4	3	8	12
2	I	7		10	8	9	2		15	2	11	3	2
9	L		14	8	12	17	12	3	7	9	9	2	
		5	7	15	5	8	5	2	16	8	5		16
4	8	6	5	2	15	8		7	15		10	7	
7	5	7		12	7	15		6	11	6	8	8	15
5	6	4	7		5	2	18	2		11	19	7	
5	4	11	6	19			9	8		4	8	6	
9	11	15		1	7	5	8		19	8	1	8	
7	6	2	14		14	7		16	11	15	7		
5	7	8	4		8	9	3	8	15	7	5		

S	A	F	O	M	A	M	L	A	F		
A	N	A	K	O	S	T	U	M	E	R	
R	K	A	K	T	O	R	I	A	L	E	
A	L	K	L	E	O	P	A	T	R	A	
F	U	K	I	T	R	E	T	I	S		
L	A	N	G	E	K	I	B	F	K		
B	U	R	G	U	A	A	A	R	I	U	
A	T	A	L	N	U	R	A	T	A		
S	K	E	D	A	R	E	A	A	O	D	
M	I	L	A	O	M	E	B	U	R	R	
A	N	A	L	I	T	I	K	E	L	E	A
T	A	T	E	A	K	T	O	R	I	T	

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

M	A	T	T	C	A	S	T	T	N	T		
A	C	H	A	B	S	H	I	K	U	E	S	I
L	E	B	I	P	T	R	A	N	S			
I	D	E	M	O	K	R	A	T	I	K	E	
I	P	A	L	E	S	T	I	N	E	Z	E	T
M	A	N	A	S	T	I	R	E	T	E	O	R
A	G	I	A	E	I	S	N	S	J			
T	A	R	T	A	R	I	O	T	S	J		
E	N	T	E	E	U	R	E	K	A	V	E	
R	E	A	L	E	R	E	F	A	R	E	T	
T	I	T	A	T	O	T	E	S	T	E	T	
A	A	T	L	A	S	T	E	R	I	C		
M	I	C	K	U	A	S	K	I	L	E	T	
I	L	R	T	R	O	M	A	N	E	T		
T	K	E	R	M	I	L	L	I	N	J	E	
R	E	A	N	A	N	E	T	M	A	D	E	M
T	E	P	A	R	E	T	A	S	A	T		
H	A	R	E	T	A	S	A	T				
M	A	K	E	T	I	A	L	I	E	N	I	
O	R	E	T	L	E	G	A	K	A	P	O	
T	E	F	I	T	I	M	E	T	A			
R	E	N	D	O	R	M	E	T	O	R	E	
A	H	O	T	L	E	T	T	R	I	S		
T	I	M	O	T	E	T	A	M	A			

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

Thënie të mençura

- Mençia e një kombi është arsimi, zemra e tij është morali i përgjithshëm
- Çdo ditë e jetës sate është një faqe e biografisë sate, kujdesu ta shkruash mirë
- Jam më i dituri ndër të gjallët, se e di një gjë, e di se nuk di asgjë.
- Ka vetëm një të mirë: dituria. Dhe vetëm një të keqe: padituria.
- Mos u ngut të zësh miq, por, kur t'i zësh, mos i braktis
- Ai që dëshiron ta ndryshojë botën, fillimisht duhet të ndryshojë veten e tij.

